


Prot. nr. 1949
dt 04.11.2019

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë



Procedura për Lëshimin, Rivlerësimin, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave.

2019

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Hyrje

Ky dokument është pronë e:

Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë

Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1
Pranë Parkut të Delegacioneve
Tiranë / Shqipëri
Po Box 205

Ndalohet çdo riprodhim ose ndryshim i këtij materiali, pa pëlqim me shkrim.

Shpërndarja e paautorizuar e këtij manuali ose pjesëve të tij, jashtë shpërndarjes zyrtare, sipas përkufizimit të këtij dokumenti, do të cilësohet si shkelje e procedurave të AAC-së dhe do të trajtohet përkatësisht me punonjësin përgjegjës.

Ky individ mund t'i nënshtrohet procedimit ligjor nga institucionet përkatëse ligjore.

Për Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar

Drejtor Ekzekutiv



Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave

Zotëruesi

O2

Dokumenti

O2-3-PRC.01

TABELA MIRATUESE

	Emri dhe pozicioni	Datë	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Krista Garo, Inspektore DMSHLA	28.10.2019	
	Juxhin Decka, Përgjegjës Sektori DMSHLA	28.10.2019	
Pranuar nga:	Arben Sula, Drejtor i DMSHLA	30.10.2019	
Kontrolluar nga:	Florian Kazazi, Inspektor i SKRC	28.10.2019	
	Elton Kacagjeli, Kordinator i SKRC	28.10.2019	
Miratuar nga:	Krislen Keri, Drejtor Ekzekutiv	04.11.2019	



LISTA E SHPERNDARJES

Përdoruesi	Media/Mediumi	Sasia
Arkivi	Në Letër	1
	Elektronike	1
DMSHLA	Në Letër	1
	Elektronike	1

REGJISTER I RISHIKIMEVE

Nr:	Datë:	Rishikuar nga:
1		



	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

TABELA PERMBLEDHESE

Kapitulli	Faqe
Hyrje	2
Lista e faqeve ekzistuese dhe tabela miratuese	3
Lista e shpërndarjes – Regjistër i rishikimeve	3
Tabela përmbledhëse	4
Parathënie	6
Përkufizimet	7
Kapitulli 1 Baza ligjore	12
Kapitulli 2 Zbatueshmëria	12
Kapitulli 3 Kërkesat e aplikueshme	12
Kapitulli 4 Përmbajtja e procedurës	12
Kapitulli 5 Lëshimi i liçensave, kategorive dhe miratimeve	13
Kapitulli 6 Rivlerësimi dhe rinovimi i liveçencave, kategorive dhe miratimeve	19
Kapitulli 7 Miratimi i Instruktorit në vendin e punës	23
Kapitulli 8 Miratimi i instruktorit në pajisje trajnimi sintetike[simulator] (STDI)	26
Kapitulli 9 Shkëmbimi i miratimit të ojti me miratim stdi	29
Kapitulli 10 Miratimet e vlerësuesit	30
Kapitulli 11 Autorizime të përkohëshme	34
Kapitulli 12 Shkëmbimi i liçensave	39
Kapitulli 13 Anulimi dhe pezullimi i liçensave, kategorive dhe miratimeve	41
Kapitulli 14 Zëvendësimi i një liçence KTA	45
Kapitulli 15 Mbajtja e rekordeve	46

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01


Kapitulli 16 Certifikata Mjekësore

47

ANEKSET

Faqe


Aneksi 1: Formati aplikimi për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve	54
Aneksi 2: Formati i Liçensës së KTA-ve	57
Aneksi 3: Formati për autorizimet e përkohshme	64

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

PARATHENIE

Përdorimi i kësaj proçedure shërben për stafin e DMSHLA-së në kryerjen e funksioneve të Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës dhe bazohet në Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.91 datë 21/02/2019 për “Mbi Përcaktimin e Kërkesave Teknike dhe Proçedurave Administrative në Lidhje me Liçensat dhe Çertifikatat e Kontrollorëve të Trafikut Ajror”


Proçedura për Lëshimin, Rivlerësimin, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave është hartuar duke pasur parasysh dhe Standartet Ndërkombëtare të ISO 9001:2008 dhe duke i përshtatur ato, me specifikat e autoritetit tonë.

 <p>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</p>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01


PERKUFIZIMET

Në funksion të kësaj procedure, termat e mëposhtëm do të kenë këto përkufizime:


Termi	Përkufizimi
<i>Autoriteti i Aviacionit Civil</i>	Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Shqipërisë
<i>SHLA</i>	Shërbimet e Lundrimit Ajror – shërbimet e trafikut ajror; komunikimi, shërbimet e lundrimit dhe mbikëqyrjes; shërbimet meteorologjike për navigimin ajror; dhe shërbimet e informacionit aeronautik.
<i>Drejtoria e Mbikëqyrjes së SHLA</i>	Drejtoria brenda AAC-së së Shqipërisë e cila ka si funksion mbikëqyrjen në ushtrimin e funksioneve të Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës AKM për SHLA.
<i>Ofruesi i SHLA</i>	SHLA-të ofrohen nga ofrues të pavarur, të cilët përcaktohen, çertifikohen dhe mbikëqyren nga AAC-ja, ku shërbimet e lundrimit ajror (SHLA) përfshijnë menaxhimin e trafikut ajror (në vazhdim MTA), komunikimin, lundrimin dhe mbikëqyrjen elektronike (në vazhdim KLME), shërbimet meteorologjike për lundrimin ajror (në vazhdim SHMNA) dhe shërbimet e informimit aeronautik (në vazhdim SHIA).
<i>APMF</i>	Aplikimi Menaxhimi Funkcioni – punët dhe përgjësitë që lidhen me DMSHLA, menaxhimi i aplikacioneve të ofruesit të shërbimeve SHLA për Çertifikim.
<i>AST</i>	Model i përmbledhjes vjetore (për raportin vjetor tek EUROCONTROL për të dhënat e ngjarjeve të sigurisë në ATM.)
<i>ATM</i>	Bashkësia e pajisjeve të instaluara në tokë (duke përmbledhur ATS, ASM, ATFM të ndryshme) dhe funksionet e avionit që kërkohen për të siguruar lëvizje të sigurtë dhe efikase të avionit gjatë gjithë fazave të operimit.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01


<i>Sistemet ATM</i>	Pjesa e sistemit SHLA e përbërë nga pjesa ATM e tokës dhe komponentit të ajrit (në avion). Sistemi ATM përmbledh njerëz, sisteme teknike dhe procedura, dhe merret me ekzistencën e një sistemi CNS të suportuar.
<i>Auditi</i>	Shih “Audit i rregullatorit për sigurinë”
<i>I audituari</i>	Person me përgjegjësi dhe autoritet për zonën që po auditohet.
<i>Audituesi</i>	Person i autorizuar që kryen audite sigurie në emër të AAC.
<i>Drejtuesi i njësisë së Çertifikimit (CTL)</i>	Personi i emëruar të drejtojë ekipin e Çertifikimit në vlerësimin e një ofruesi SHNA që ka aplikuar për Çertifikim.
<i>Autoriteti i Aviacionit Civil</i>	Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Shqipërisë
<i>Kërkesat e përbashkëta</i>	Kërkesa të shkruara në Urdhrin e Ministrit të Transporteve Nr. 115 datë 23.10.2012 “Për Miratimin e Rregullores mbi Kërkesat e Përbashkëta për Ofrimin e Shërbimeve të Lundrimit Ajror” sipas nenit 6 të Udhëzimit të Ministrit të Transporteve Nr. 6, datë 03-06-2010 të cilat duhet të përmbushen nga ofruesi i shërbimit (SHNA) në mënyrë që të çertifikohet për të ofruar shërbime.
<i>Autoriteti i përcaktuar</i>	Organi kompetent përcaktuar si autoriteti shtetëror, përgjegjës për rregulloret e sigurisë në aviacion.
<i>EASA</i>	Agjencia e Sigurisë së Aviacionit Evropian
<i>EC</i>	Komisioni Evropian
<i>FIR</i>	Kërkesat e rregullatorit të sigurisë sipas EUROCONTROL, të transpozuar në legjislacionin kombëtar: <ul style="list-style-type: none"> i. Udhëzim i Ministrit të Transporteve Nr. 19 datë 16-10-2008 ii. Udhëzim i Ministrit të Transporteve Nr. 20 datë 16-10-2008 iii. Udhëzim i Ministrit të Transporteve Nr. 21 datë 16-10-2008 iv. Udhëzim i Ministrit të Transporteve Nr. 22 datë 16-10-2008 v. Udhëzim i Ministrit të Transporteve Nr. 09 datë 03-06-2010

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01


<i>EU</i>	Bashkimi Evropian
<i>EUROCAE</i>	Organizata Europiane për Pajisjet në Aviacionin Civil
<i>FHA</i>	Analiza Funktionale e Rrezikut
<i>Drejtori i Drejtorise se Mbikeqyrjes se SHLA</i>	Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes SHLA.
<i>Inspektimi</i>	Një zgjerim i procesit të auditit për të verifikuar që produkti final dhe/ose shërbimi është në përputhje me kërkesat dhe procedurat e aprovuara, si edhe efektivitetin e vet procesit.
<i>JAA</i>	Autoritetet e Bashkuara të Aviacionit
<i>JAR</i>	Kërkesat e Autoriteteve të Bashkuar të Aviacionit
<i>Audituesi udhëheqës</i>	Audituesi përgjegjës për gjithë grupin e auditimit.
<i>Autoriteti kombëtar i mbikëqyrjes (AKM)</i>	Autoriteti i Aviacionit Civil, siç është përcaktuar në Kodin Ajror.
<i>Organi njoftues</i>	Një organizatë e aftë të kryejë punët që lidhen me vlerësimet EC të konformitetit ose përshtatshmërisë të ndërrimit të sistemeve teknike dhe/ose verifikimi EC i sistemeve teknike.
<i>PoR</i>	Pika përgjegjëse – njësia e emëruar brenda AKM për të marrë raportet e auditit dhe të ndërmarrë veprimet e duhura në përputhje me ESARR 1 në lidhje me gjetjet e auditit.
<i>PSSA</i>	Vlerësim fillestar i sigurisë së sistemit
<i>Organizatat e njohura</i>	Organizatë quhet ajo që është vlerësuar dhe çertifikuar nga AKM e një shteti EU si e aftë për të drejtuar mbikëqyrje dhe vlerësime të ofruesve të shërbimit SHLA për verifikimin e përputhshmërisë me një ose disa nga kërkesat e përbashkëta.
<i>Bërja e rregullave</i>	Proçesi nga i cili vendosen objektivat e sigurisë dhe kërkesat.
<i>Direktivat e sigurisë</i>	Një dokument i marrë ose adoptuar nga AKM, i cili përcakton hapat

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

	që do ndërmerren në një sistem për të vendosur një nivel të tolerueshëm sigurie, kur evidenca tregon që siguria e aviacionit mund të kompromentohet.
<i>Mbikëqyrja e Sigurisë</i>	Funksionet e ndërmarra nga një AKM për të verifikuar që objektivat rregullatore të sigurisë dhe kërkesat janë plotësuar në mënyrë efikase.
<i>Rregullore e sigurisë</i>	Proçesi i prodhimit të rregullave dhe mbikëqyrja e të gjithë aspekteve që lidhen me sigurinë e sistemit, proçedurat, praktikat dhe personelin nën kontrollin e ofruesit të shërbimit.
<i>Auditimi rregullator i Sigurisë</i>	Një testim sistematik dhe i pavarur i drejtuar nga, ose për AKM, për të përcaktuar nëse plotësisht marrëveshjet e lidhura për sigurinë ose elementët e saj, për proçeset dhe rezultatet e tyre, produktet ose shërbimet, përputhen me marrëveshjet e kërkuara që lidhen me sigurinë dhe nqs janë implementuar me efikasitet për të dhënë rezultatet e kërkuara.
<i>Qielli i vetëm Evropian (SES)</i>	Një koncept dhe një set rregulloresh ndihmëse për një operim të qetë të sistemit të transportit ajror e kombinuar me qëndrueshmëri, nivel i lartë sigurie për shërbimet e navigimit ajror në mënyrë që të lejojë përdorim optimal dhe të qëndrueshëm të hapësirës ajrore evropiane, siguri të lartë në udhëtimin ajror, në përputhje me detyrën dhe interesin e përgjithshëm të shërbimeve të navigimit ajror, duke përfshirë edhe detyrimet për shërbimet publike. Shërbimi i ofruar duhet të mbahet në një standard dhe kompetencë të lartë.
<i>SSA</i>	Vlerësimi i sigurisë së sistemit
<i>Plan i Trajnimit të njësisë (UTP)</i>	Një plan i krijuar nga një njësi ATC operationale dhe aprovuar nga autoriteti i përcaktuar, për të dhënë trajnim të strukturuar mbi objektiva të caktuara në mënyrë që personeli mund të arrijë dhe të mbajë standartet dhe plotësimin e kërkesave sipas skemës së kompetencave të njësisë.
<i>Ndërveprimi</i>	Nënkupton një sërë karakteristikash funksionale, teknike dhe operationale kërkuar nga sistemet dhe përbërësit e EATMN dhe proçedurave për funksionimin e tyre, në mënyrë që të mundësojë funksionimin e tij të sigurtë dhe efikas. Ndërveprimi është realizuar duke bërë sistemet dhe përbërësit të përputhshëm me kërkesat

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

	thelbësore.
<i>Rrjeti i Menaxhimit të Trafikut Ajror Evropian (EATMN)</i>	<p>Nënkupton mbledhjen e sistemeve të listuar në Aneksin 1 Udhëzimin e Ministrit të Transporteve Nr. 8 datë 03-06-2010 mbi “Ndërveprimi në Rrjetin Evropian të Menaxhimit të Trafikut Ajror” duke mundësuar shërbimet e navigimit ajror në bashkësi që duhet të ofrohen, duke përfshirë ndërveprimin në kufijtë me vendet e treta e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Transporteve Nr. 5, datë 03-06-2010 “Krijimin e strukturës së Qiellit të Vetëm Evropian”</p>
<i>Sistemi</i>	<p>Në kontekstin e ndërveprimit, sistemet nënkuptojnë grumbullimin e përbërësve bazuar në tokë dhe ajër si dhe pajisjet e bazuar në hapësirë që ofrojnë mbështetje për shërbimet e navigimit ajror për të gjitha fazat e fluturimit e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Transporteve Nr. 5, datë 03-06-2010 “Krijimin e strukturës së Qiellit të Vetëm Evropian”</p>
<i>Përbërësit</i>	<p>Në kontekstin e ndërveprimit përbërësit janë përkufizuar si objekte të prekshme të tilla si pajisje dhe objekte jo materiale të tilla si programe mbi të cilat varet ndërveprimi i EATMN e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Transporteve Nr. 5, datë 03-06-2010 “Krijimin e Strukturës së Qiellit të Vetëm Evropian”.</p>

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

1. BAZA LIGJORE

Kjo procedurë i referohet bazës ligjore të mëposhtme:

1. Rregullores së komisionit (EU) Nr. 2015/340 e 20 Shkurtit 2015 e cila paraqet kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me liçensat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror dhe të transpozuar në Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019.

2. ZBATUESHMËRIA

Kjo Procedurë do të aplikohet tek:

- a. Staf i DMSHLA-së që merret me lëshimin, rivlerësimin, rinovimin, pezullimin dhe anulimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve përkatëse;
- b. Ofruesit e Shërbimit të Trafikut Ajror;
- c. Ofruesit e Shërbimit të Trafikut Ajror që mundësojnë trajnime për KTA, si trajnime fillestare, trajnime njësie (kurse për miratimin e njësisë) dhe trajnime të vazhdimësisë;
- d. Organizata të tjera trajnimi përveç Ofruesit e Shërbimit të Trafikut Ajror.


Kjo procedurë do të jetë në fuqi menjëherë pas firmosjes nga Drejtori Ekzekutiv i AAC.

3. KËRKESAT E APLIKUESHME

Kjo procedurë është e zbatueshme për lëshimin, rivlerësimin, rinovimin, pezullimin, anulimin dhe këmbimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve për KTA në përputhje me Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I – Pjesa KTA, Nën pjesa A, B, C dhe Aneksi II- Pjesa KTA.AR, Nën pjesa D.

4. PËRMBAJTJA E PROCEDURËS

Procedura adreson:

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

- a. Lëshimin, rivlerësimin, dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve;
- b. Autorizimet e përkohshme;
- c. Këmbimin e liçensave;
- d. Pezullimin dhe anulimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve;
- e. Zëvendësimin e një liçense KTA;
- f. Ruajtja e rekordeve.

5. LËSHIMI I LIÇENSAVE, KATEGORIVE DHE MIRATIMEVE

5.1 Të përgjithshme

Kur aplikanti plotëson kërkesat e Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I – Pjesa KTA dhe të kësaj procedure, AAC do të lëshojë, rishikojë dhe rivlerësojë liçensën përkatëse, kategorinë /të dhe miratimin/et përkatëse .

AAC lëshon liçensat të cilat specifikojnë gjithë informacionin përkatës lidhur me privilegjet e dhëna nga liçensa, në përputhje me kërkesat e Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi II – Shtojca 1.

5.2 Lëshimi i liçensës Student KTA


5.2.1 Privilegjet

Zotëruesit e një liçence Student kontrollori të trafikut ajror do të jenë të autorizuar për të ofruar shërbimet e trafikut ajror në përputhje me kategorinë dhe miratimet e kategorisë në liçensën e tyre, nën mbikëqyrjen e një instruktori trajnimi në vendin e punës (ITVP) dhe të ndërmarrë trajnimin për miratimin e kategorive.

5.2.2 Lëshimi i një Liçense Student KTA

Aplikimet për një Liçencë Student KTA do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksin I – Formulari aplikimit për lëshimin, Rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve.

Aplikimi do të paraqitet AAC-së nga OSHLA ose aplikanti sapa të jetë e mundur, por jo më vonë se 2 muaj pas kryerjes me sukses të një kursi trajnimi fillestar të miratuar nga AAC.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Forma e aplikimit do të jetë e shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëme:

- a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti);
- b. Çertifikatë e trajnimit fillestar lëshuar nga një organizatë trajnimi e certifikuar;
- c. Nivel i mjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (certifikatë);
- d. Një çertifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3 e lëshuar nga një Qendër Aero Mjekësore (AeMC) ose AME;
- e. Vërtetim i pagesës së detyrimeve nëse është e aplikueshme.

Me marrjen e plotë të dokumentave, AAC do të verifikojë nëse plotësohen të gjitha kërkesat e përshkruara në Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I- Pjesa KTA, KTA.B.001. Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA-së duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC lëshon licensën Student KTA, në përputhje me modelin e Aneksit 2 – liçensa KTA.

Liçensa Student KTA mban miratimin e gjuhës dhe të paktën një kategori dhe, nëse është e aplikueshme, një miratim kategorie.

Udhëzim

Aplikimi për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive, miratimeve dhe autorizimeve, bashkë me gjithë certifikatat përkatëse dhe dokumentat mbështetëse për aplikim, mund të paraqiten me mënyra elektronike të sigurta.


Data e përfundimit me sukses të trajnimit të lidhur me kategorinë dhe/ose miratimin e kategorisë dhe që do të përfaqësohet në liçencën e Student KTA, do të jetë data e shënuar në certifikatën e përfundimit me sukses të trajnimit, lëshuar nga organizata e trajnimit.

AAC mund të fusë në pikën (XIII) të formës liçencës gjithë informacionin shtesë të liçensimit, si miratime liçence kombëtare.

5.2.3 Situata të veçanta

Zotëruesi i një liçence Student KTA i cili:

- a. nuk ka filluar ushtrimin e privilegjeve të kësaj liçence brenda një viti nga data e lëshimit të saj, ose

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

- b. ka ndërprerë ushtrimin e këtyre privilegjeve për një kohë më të gjatë se një vit,

mundet të nisë apo vazhdojë trajnimin e njësisë në atë kategori vetëm pas një vlerësimi të kompetencës së mëparshme nga një organizatë trajnimi e cila plotëson kërkesat e përcaktuara në Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi II-Pjesa KTA.OR dhe të çertifikuar për të mundësuar trajnim fillestar lidhur me kategorinë. Ky vlerësim përcakton nëse ai/a jo vazhdon të plotësojë kërkesat e lidhura me atë kategori dhe cilat janë kërkesat për trajnimin që dalin nga ky vlerësim.

5.3 Lëshimi i një Liçense KTA

5.3.1 Privilegjet


Zotëruesit e një liçence kontrollori të trafikut ajror do të jenë i autorizuar për të ofruar shërbimet e trafikut ajror në përputhje me kategoritë dhe miratimet e kategorive të liçencës së tyre dhe të ushtrorjnë privilegjet e miratimeve të cilat ka. Privilegjet e një liçence kontrollori të trafikut ajror përfshijnë privilegjet e një liçense Student kontrollori trafiku ajror.

5.3.2 Lëshimi i një Liçense KTA

Aplikimet për një Liçensë KTA do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksin I – Formulari aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do të paraqitet AAC-së jo më vonë se 4 javë pas plotësimit me sukses të një kursi njësie të miratuar nga AAC.

Forma e aplikimit do të jetë e shoqëruar nga dokumentat e mëposhtme:

- a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti);
- b. Liçencë e Student KTA;
- c. Vërtetim i përfundimit me sukses të një kursi të miratimit të njësisë të aprovuar (p.sh. certifikata/diploma);
- d. Nivel i mjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);
- e. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- f. Vërtetim i pagimit të detyrimeve ,nëse është i aplikueshëm.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Me marrjen e plotë të dokumentave, AAC do të verifikojë nëse plotësohen të gjitha kërkesat e përshkruara (Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I- Pjesa KTA, KTA.B.005).

Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA-së duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC lëshon licensën e KTA në përputhje me modelin e Aneksit 2 – liçensa KTA.

Liçensa e kontrollorit të trafikut ajror lëshohet duke përfshir një ose më shumë kategori dhe miratime të njësisë si edhe të aftësisë gjuhës, për të cilën është kryer me sukses trajnimi..

Udhëzim

Aplikimi për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive, miratimeve dhe autorizimeve, bashkë me gjithë certifikatat e përshtatshme dhe/ose dokumentat mbështetëse për aplikim, mund të dorëzohen me mënyra elektronike të sigurta.

AAC mund të fusë në pikën (XII) të formës liçensës gjithë informacionin shtesë të liçencimit, si miratime të liçencës kombëtare, etj.).

Periudha e vlefshmërisë së një miratimi të njësisë përcaktohet në skemën e kompetencës së njësisë e cila përgatitet nga OSHNA dhe miratohet nga AAC. Kjo periudhë nuk duhet t'i kalojë 3 (tre) vjet.


Me lëshimin e liçencës KTA, liçensa Student KTA anulohet dhe duhet ti kthehet AAC-së nga zotëruesi.

5.4 Lëshimi i Kategorive Shtesë dhe/ose Miratimeve të Kategorive të një Liçence KTA

Aplikimet për kategori shtesë dhe/ose miratim/e të kategorive do të bëhen në formularin e mundësuar nga AAC në Aneksi I – formulari i aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve.

Forma e aplikimit do të jetë e shoqëruar nga dokumentat e mëposhtme:

- a. Liçencë e vlefshme KTA;

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

- b. Vërtetim i përfundimit me sukses të një trajnimit kategorie të aprovuar që lidhet me kategorinë dhe/ose miratimin e kategorisë;
- c. Nivel i mjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);
- d. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- e. Vërtetim i pagimit të detyrimeve nëse është i aplikueshme.

Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes. AAC i lëshon liçensat KTA në përputhje me modelin nga Aneksi 2 – Liçensa KTA.

5.5 Lëshimi i Miratimeve Njësi Shtesë

Aplikimet për miratime njësi shtesë do të bëhen në formularin e mundësuar nga AAC në Aneksi I – formulari i aplikimit për lëshimin, Rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve.

Forma e aplikimit do të jetë e shoqëruar nga dokumentat e mëposhtme:


- a. Liçensë e vlefshme KTA;
- b. Vërtetim i përfundimit me sukses të një kursi miratimi njësi të aprovuar;
- c. Nivel i mjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);
- d. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- e. Vërtetim i pagimit të detyrimeve nëse është i aplikueshme.

Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA-së duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes. AAC i lëshon liçensat KTA në përputhje me modelin nga Aneksi 2 – Liçensa KTA.

Udhëzim

Aplikimi për lëshimin, rivalidimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive, miratimeve dhe autorizimeve, bashkë me gjithë certifikatat e përshtatshme dhe/ose dokumentat mbështetëse për aplikim, mund të paraqiten në mënyra elektronike të sigurt.

Periudha e vlefshmërisë së një miratimi të njësisë përcaktohet në skemën e kompetencës së njësisë e cila përgatitet nga OSHNA dhe miratohet nga AAC. Kjo periudhë nuk duhet t'i kalojë 3 (tre) vjet.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

5.6 Lëshimi i Miratimeve të Aftësisë së Gjuhës

5.6.1 Privilegjet

Kontrollorët e trafikut ajror dhe studentë kontrollorët e trafikut ajror nuk duhet të ushtrojnë privilegjet e liçensave të tyre nëse nuk kanë një miratim të aftësisë gjuhësore të vlefshëm për gjuhën Angleze.

5.6.2 Lëshimi i Miratimeve të Aftësisë Gjuhës

Aplikimet për miratimet e gjuhës do të bëhen në formularin e mundësuar nga AAC në Aneksin I – formulari i aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve.

Forma e aplikimit do të jetë e shoqëruar nga dokumentat e mëposhtme:

- Vërtetim i përfundimit me sukses të vlerësimit të gjuhës (p.sh. certifikatë);
- Certifikata duhet të përmbajë minimalisht Nivelin 4 ICAO.
- Vërtetim i pagimit të detyrimeve nëse është i aplikueshëm.


Me marrjen e plotë të dokumentave, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I- Pjesa KTA, KTA.B.030). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA-së duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC lëshon miratimet e aftësisë gjuhësore në përputhje me modelin nga Aneksi 2 – liçensa KTA. Miratimi i aftësisë të gjuhës do të tregojë gjuhën/t, nivelin/et e aftësisë dhe datën/at e mbarimit të afatit.

5.6.3 Vlefshmëria Miratimeve të Aftësisë Gjuhës

Vlefshmëria miratimit të aftësisë së gjuhës, në varësi të nivelit të përcaktuar në përputhje me Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Shtojca 1 e Aneksi I, do të jetë:

- Niveli operacional (niveli katër): tre vjet nga data e vlerësimit, ose
- Niveli i zgjeruar (niveli pesë): gjashtë vjet nga data e vlerësimit;
- Niveli ekspert (niveli gjashtë):

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

- (i) nëntë vjet nga data e vlerësimit, për gjuhën Angleze;
- (ii) e palimituar, për çdo lloj tjetër gjuhe referuar Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019,, KTA.B.030(a).

6. RIVLERËSIMI DHE RINOVIMI I LIVEÇENSAVE, KATEGORIVE DHE MIRATIMEVE

6.1 Të përgjithshme

Liçensat nuk kanë vlefshmëri. Në këtë mënyrë, zotëruesi i liçencës KTA varet nga vlefshmëria e kategorive, miratimeve të liçencës ose miratimeve të njësive për të qenë të aftë për të ushtruar privilegjet e liçensës së tij/saj.

6.2 Kategoritë


Zotëruesi i një kategorie i cili ka ndërprerë ushtrimin e privilegjeve lidhur me atë kategori për një periudhë prej 4 (katër) ose më shumë viteve, mund të fillojë trajnimin e njësisë në atë kategori vetëm pas vlerësimit të kompetencës së mëparshme, të kryer nga një organizatë trajnimi duke plotësuar kërkesat e përcaktuara në Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi III – Pjesa KTA.OR dhe të çertifikuara për të mundësuar trajnimin lidhur me kategorinë. Vlerësimi siguron nëse personi në fjalë vazhdon të plotësojë kushtet e asaj kategorie dhe cilat janë kërkesat e trajnimit që mund të dalin nga ky vlerësim.

Si e tillë, AAC do të njoftohet nga organizata OSHNA/trajnuese rreth rasteve të tilla, bashkë me informacionin e mëposhtëm:

- a. Vlerësimi i kompetencës së mëparshme të zotëruesit të liçencës nga një organizatë trajnimi e çertifikuar e përfshirë dhe në një raport vlerësimi;
- b. Paraqitja e trajnimit të njësisë (i lidhur me rezultatet e vlerësimit) për miratimin e AAC
- c. Provë e kalimit të vlerësimit në fund të trajnimit.

Për më tepër, mund të kërkohen dokumentat e mëposhtëm nga ana e AAC:

- a. Nivel i mjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

- b. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- c. Vërtetim i pagimit të detyrimeve nëse është i aplikueshëm.

Bazuar në këtë informacion, AAC do të përfshijë një periudhë të re vlefshmërie për kategorinë dhe miratimet e lidhur në liçensën KTA në përputhje me modelin nga Aneksi 2 – liçensa KTA.


6.3 Rivlerësimi i Miratimeve të Njesisë

Aplikimet për rivlerësimin e miratimeve të njesisë do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksin 1 – Forma e aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do t'i paraqitet AAC-së jo më vonë se 7 ditë para datës së përfundimit të afatit të miratimit.

Formulari i aplikimit do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:

- a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti), nëse është i nevojshëm;
- b. Liçensë KTA;
- c. Vërtetim i përfundimit me sukses të një trajnimi rifreskues të miratuar (p.sh. certifikata/diploma) brenda kohës vlefshmërisë;
- d. Vërtetim që aplikanti ka ushtruar privilegjet e liçensës për një numër minimal orësh (si përshkruhet në skemën e kompetencës së njesisë);
- e. Vërtetim që kompetenca e aplikantit është vlerësuar jo më herët se 3 muaj para datës së përfundimit afatit (si në skemën e kompetencës së njesisë);
- f. Nivel i mjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);
- g. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- h. Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është i aplikueshëm

Me marrjen e plotë të dokumentasve, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019,, Aneksi I- Pjesa KTA, KTA.B.020). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA-së duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

AAC rivlaidon miratimin e njësisë në përputhje me modelin e Aneksit 2 – liçensa KTA.

6.4 Rinovimi i Miratimeve të Njësisë

Aplikimet për rinovimin e miratimeve të njësisë do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksin 1 – Forma e aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do t'i paraqitet AAC jo më vonë se 4 javë pas datës së përfundimit me sukses të vlerësimit të kursit të miratimit të njësisë.

Formulari i aplikimit do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:

- a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti), nëse është i nevojshëm;
- b. Liçencë KTA;
- c. Vërtetim i përfundimit të suksesshëm të një kursi për miratimi njësie të aprovuar (p.sh. certifikata/diploma);
- d. Nivel i mjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);
- e. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- f. Vërtetim i pagimit të detyrimeve , nëse është i aplikueshëm.


Me marrjen e plotë të dokumentave, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I-Pjesa KTA, KTA.B.020). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA-së duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC rinovon miratimin e njësisë në përputhje me modelin e Aneksit 2 – liçensa KTA.

6.5 Rivlerësimi i Miratimeve të Gjuhës

Aplikimet për Rivlerësimin e miratimit të gjuhës Angleze do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksi 1 – Forma e aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do t'i paraqitet AAC-së jo më vonë se 7 ditë para datës së përfundimit të afatit të miratimit.

Formulari i aplikimit do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

- a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti), nëse është i nevojshëm;
- b. Liçensë KTA;
- c. Vërtetim i përfundimit me sukses të vlerësimit të aftësisë gjuhës (p.sh. certifikata/diploma) brenda 3 muajve përpara përfundimit të afatit;
- d. Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është i aplikueshëm

Me marrjen e një grupi të plotë dokumentash, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I- Pjesa KTA, KTA.B.035). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA-së duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC rivalidon miratimin e gjuhës në përputhje me modelin e Aneksin 2 – liçensa KTA.

6.6 Rinovimi i Miratimeve të Gjuhës


Aplikimet për rinovimin e miratimit të gjuhës Angleze do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksin1 – Forma e aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do t'i paraqitet AAC jo më vonë se 4 javë pas datës së përfundimit afatit të miratimit.

Formulari i aplikimit do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:

- a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti), nëse është i nevojshëm;
- b. Liçencë KTA;
- c. Vërtetim i përfundimit me sukses të vlerësimit të aftësisë gjuhës (p.sh. certifikata/diploma);
- d. Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është i aplikueshëm.

Me marrjen e plotë të dokumentave, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I- Pjesa KTA, KTA.B.035). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC rinovon miratimin e gjuhës në përputhje me modelin nga Aneksi II – liçensa KTA.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

7. MIRATIMI I INSTRUKTORIT NË VENDIN E PUNËS

7.1 Privilegjet

Zotëruesit e një miratimi OJTI (Instruktor Trajnimi në Vendin e Punës) janë të autorizuar për të ofruar trajnim praktik dhe mbikëqyrje në pozicionet operacionale të punës për të cilat ka një miratim njësie të vlefshëm dhe në pajisjet trajnuese sintetike (STD) në kategoritë që mban.

7.2 Lëshimi i Miratimeve OJTI

Aplikimet për një miratim OJTI do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksi1 – Forma e aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do t'i paraqitet AAC jo më vonë se një vit pas përfundimit me sukses të një kursi të aprovuar të teknikave instruksionale praktike.


Formulari i aplikimit do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:

- Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti), nëse është i nevojshëm;
- Liçencë KTA;
- Vërtetim i përfundimit me sukses të një kursi të aprovuar teknikash instruksionale praktike (p.sh. certifikata/diploma) jo më tepër se 1 vit para aplikimit për OJTI;
- Niveli i mjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);
- Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është i aplikueshëm

Udhëzim

Një kopje e liçencës KTA kërkohet për të kontrolluar që:

- ka një miratim të njësisë të vlefshëm; dhe*
- zotëruesi ka ushtruar privilegjet e liçensës KTA për një periudhë prej të paktën 2 vjet përpara aplikimit për OJTI. Kjo periudhë mund të shkurtrohet nga AAC kur kërkohet nga organizata e trajnimit, por nuk do të jetë më pak se një vit.*

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Me marrjen e plotë të dokumentave, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I-Pjesa KTA, KTA.C.015). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC lëshon miratimin OJTI në përputhje me modelin e Aneksit 2 – liçensa KTA.

7.3 Vlefshmëria

Periodha vlefshmërisë e një miratimi OJTI është 3 (tre) vjet. Periodha e vlefshmërisë do të nisë jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën u përfundua me sukses vlerësimi.

7.4 Rivlerësimi i Miratimeve të OJTI

Aplikimet për rivalidimin e miratimit OJTI do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksi 1 – Forma e aplikimit për lëshimin, Rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do t'i paraqitet AAC-së jo më vonë se 7 ditë para datës përfundimit të miratimit.


Formulari i aplikimit do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:

- a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti), nëse është i nevojshëm;
- b. Liçencë KTA;
- c. Vërtetim i përfundimit të suksesshëm të një trajnimi rifreskues të aprovuar mbi aftësitë instruksionale praktike (p.sh.certifikata/diploma) brenda periudhës vlefshmërisë;
- d. Vërtetim i nivelit të mjaftueshëm të aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);
- e. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- f. Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është i aplikueshëm.

Udhëzim

Një kopje e liçencës KTA kërkohet për të kontrolluar që:

- i. ka një miratim të njësisë të vlefshëm; dhe*
- ii. zotëruesi ka ushtruar privilegjet e liçensës tij siKTA për një periudhë prej të paktën 2 vjet përpara aplikimit për OJTI. Kjo periudhë mund të shkurtrohet nga AAC kur kërkohet nga organizata e trajnimit, por nuk do të jetë më pak se një vit.*

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Me marrjen e një grupi të plotë dokumentash, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I- Pjesa KTA, KTA.C.020). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC rivlerëson miratimin OJTI në përputhje me modelin e Aneksit 2 – liçensa KTA.

7.5 Rinovimi i Miratimeve të OJTI


Aplikimet për rinovimin e miratimeve të OJTI do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksi1 – Forma e aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do t'i paraqitet AAC nëpërmjet formularit të aplikimit i cili do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm::

- a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti), nëse është i nevojshëm;
- b. Liçencë KTA;
- c. Vërtetim i përfundimit me sukses të një trajnimi rifreskues të aprovuar mbi aftësitë instruksionale praktike (p.sh. certifikata/diploma) brenda 1 viti para aplikimit për rinovim;
- d. Vërtetim i kalimit të suksesshëm të një vlerësimi kompetence të instruksioneve praktike brenda 1 viti menjëherë para aplikimit për rinovim;
- e. Vërtetim i nivelit të mjaftueshëm të aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);
- f. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- g. Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është i aplikueshëm.

Udhëzim

Një kopje e liçencës KTA kërkohet për të kontrolluar që:

- i. ka një miratim të njësisë të vlefshëm; dhe*
- ii. zotëruesi ka ushtruar privilegjet e liçensës tij KTA për një periudhë prej të paktën 2 vjet para aplikimit për OJTI. Kjo periudhë mund të shkurtohet nga AAC kur kërkohet nga organizata e trajnimit, por nuk do të jetë më pak se një vit.*

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Me marrjen e plotë të dokumentave, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I-Pjesa KTA, KTA.C.020). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC rinovon miratimin OJTI në përputhje me modelin nga Aneksi 2 – liçensa KTA. Periudha e vlefshmërisë do të nisë jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën është përfunduar me sukses vlerësimi kompetences të instruksioneve praktike.

8. MIRATIMI I INSTRUKTORIT NË PAJISJE TRAJNIMI SINTETIKE [SIMULATOR] (STDI)

8.1 Privilegjet

Zotëruesit e një miratimi STDI janë të autorizuar të mundësojnë trajnim praktik në pajisjet e trajnimit sintetike për:


- a. subjekte të natyrës praktike gjatë trajnimit fillestar;
- b. trajnime të tjera njësi përveç OJT; dhe
- c. trajnime të vazhdimësisë.

Ku STDI kryen pre-OJT, ai/ajo duhet të mbajë, miratimin e njësisë përkatëse.

8.2 Lëshimi i Miratimit të STDI

Aplikimet për një miratim STDI do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksin 41 – Forma e aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do t'i paraqitet AAC nëpërmjet formularit të aplikimit i cili do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:

- a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti), nëse është i nevojshëm;
- b. Liçencë KTA;
- c. Vërtetim i përfundimit të suksesshëm të një kursi të aprovuar mbi teknikat instruksionale praktike (p.sh. certifikata/diploma) brenda një viti para aplikimit, për aplikimin e STDI;
- d. Nivelit i mjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

- e. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- f. Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është i aplikueshëm.

Udhëzim

Një kopje e liçencës KTA kërkohet për të kontrolluar që zotëruesi ka ushtruar privilegjet e një liçence të kontrollorit të trafikut ajror në çdo kategori për të paktën 2 vjet.

Me marrjen e plotë të dokumentave, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I-Pjesa KTA, KTA.C.035). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC lëshon miratimin e STDI në përputhje me modelin në Aneksin 2 – liçensa KTA.


8.3 Vlefshmëria

Periodha e vlefshmërisë e një miratimi STDI është 3 (tre) vjet. Periodha e vlefshmërisë duhet të nisë jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën është përfunduar me sukses vlerësimi.

8.4 Rivlerësimi i Miratimeve të STDI

Aplikimet për rivlerësimin e STDI do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksin 1 – Forma e aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do t'i paraqitet AAC nëpërmjet formularit të aplikimit i cili do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:

- a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti), nëse është i nevojshëm;
- b. Liçencë KTA;
- c. Vërtetim i përfundimit me sukses të një trajnimi rifreskues të aprovuar mbi aftësitë instruksionale praktike (p.sh. certifikata/diploma) brenda periudhës së vlefshmërisë;
- d. Vërtetim i kalimit të suksesshëm të një trajnimi të aprovuar mbi praktikat operacionale aktuale brenda periudhës së vlefshmërisë;
- e. Nivel imjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

- f. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- g. Vërtetim i pagimit të detyrimeve ,nëse është i aplikueshëm.

Udhëzim

Çdo trajnim rifreskues do të kryhet nga një verifikim i cili mund të bëhet nga mënyra të ndryshme:

- i. vlerësim i dedikuar ose i vazhdueshëm*
- ii. vlerësim i kolegëve; ose*
- iii. paraqitje e aftësive të instruksionale praktike.*


Rezultatet nga një verifikim i tillë duhet të dokumentohen nga organizata OSHNA/ trajnuese.

Me marrjen e plotë të dokumentave, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I-Pjesa KTA, KTA.C.040). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes

AAC rivlerëson miratimin e STDI në përputhje me modeline Aneksit 2 – liçensa KTA.

8.5 Rinovimi Miratimit të STDI

- a. Aplikimet për rinovimin e miratimeve të STDI do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksin 1 – Forma e aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do t'i paraqitet AAC nëpërmjet formularit të aplikimit i cili do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm: Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti), nëse është i nevojshëm;
- b. Liçencë KTA;
- c. Vërtetim i përfundimit të suksesshëm të një trajnimit rifreskues të aprovuar mbi aftësitë instruksionale praktike (p.sh. certifikata/diploma) brenda një viti para aplikimit për rinovim;
- d. Vërtetim i kalimit të suksesshëm të një trajnimit të aprovuar mbi praktikën operacionale aktuale brenda një viti para aplikimit për rinovim;

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

- e. Vërtetim i kalimit të suksesshëm të një vlerësimi kompetence të instruksioneve praktike brenda vitit para aplikimit për rinovim;
- f. Nivel imjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);
- g. Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është i aplikueshëm.

Me marrjen e plotë të dokumentave, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I-Pjesa KTA, KTA.C.020). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC rinovon miratimin STDI në përputhje me modeline Aneksit 2 – liçensa KTA. Periudha e vlefshmërisë do të nisë jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën është përfunduar me sukses vlerësimi.

9. SHKËMBIMI I MIRATIMIT TË OJTI ME MIRATIM STDI


9.1 Kushtet për Shkëmbimin e Miratimit OJTI me Miratim STDI

Një miratim OJTI mund të shkëmbehet me një miratim STDI kur nuk plotësohen kërkesat e mëposhtme:

- a. Zotërimi i një liçense kontrollori trafiku ajror me një miratim të vlefshëm njësie;
- b. ka ushtruar privilegjet e një liçense të kontrollorit të trafikut ajror për një periudhë të paktën dy vjeçare menjëherë para paraqitjes së aplikimit. Në rastin kur kjo periudhë shkurtohet (jo më pak se një vit) nga AAC me kërkesë nga organizata trajnuese, kërkesa i referohet kësaj periudhe.

Si shtesë, për kërkesat e mëposhtme duhet të ketë ndodhur më parë shkëmbimi i miratimeve (shikoni Rivalidimin dhe Rinovimin për Miratimin STDI):

- a) Miratimi i STDI mund të rivalidohet duke përfunduar me sukses trajnimin rifreskues në aftësitë instruksionale praktike dhe në praktikat operacionale aktuale gjatë periudhës së vlefshmërisë tyre.
- b) Nëse miratimit STDI i ka përfunduar afati, ai mund të rinovohet nga:
 - i. Kryerja e trajnimit rifreskues në aftësi instruksionale praktike dhe praktika operacionale aktuale; dhe

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

ii. Kalimi me sukses i një vlerësimi kompetence nga një instruktor praktik; brenda vitit para paraqitjes së aplikimit për rinovim.

9.2 Procesi i Shkëmbimit dhe Shënimi i tij në Liçencën KTA

Aplikimet për shkëmbimin e miratimit OJTI me miratimin STDI do të bëhet nga organizata OSHNA/trajnuese me shkrim tek AAC.

Çdo aplikim do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:

- a. Liçencë KTA;
- b. Justifikimi i kërkesës
- c. Nivel i përshtatshëm i aftësisë gjuhës (p.sh. certifikatë);
- d. Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është i aplikueshëm.

Me marrjen e plotë të dokumentave, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I-Pjesa KTA.C.020 pika e. Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.


AAC do të përfshijë miratimin STDI në përputhje me modeline Aneksit 2 – liçensa KTA.

10. MIRATIMET E VLERËSUESIT

10.1 Privilegjet

Një person do të kryejë vlerësime vetëm kur ai/ajo zotëron një miratim vlerësuesi. Zotëruesit e një miratimi vlerësuesi janë të autorizuar të kryejnë vlerësime:

- a. gjatë trajnimit fillestar për lëshimin e një liçense student kontrollori trafiku ajror, ose për lëshimin e një kategorie të re dhe/ose miratimit të kategorisë, nëse është e aplikueshme;
- b. të kompetencave të mëparshme për qëllim të Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, KTA.B.001(d) dhe KTA.B.010(b);
- c. të student kontrollorëve të trafikut ajror për lëshimin e një miratimi njësie dhe miratimeve të kategorive, nëse është e aplikueshme;

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

- d. të kontrollorëve të trafikut ajror për lëshimin e një miratimi njësie dhe miratimeve të kategorive; nëse është; e aplikueshme, gjithashtu edhe për Rivlerësimin dhe rinovimin e një miratimi njësie;
- e. të instruktorëve praktikë ose aplikantëve pëvlerësues kur sigurohet përputhja me kërkesat e Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, KTA.C.045 (d)(2) deri (4).

10.2 Lëshimi i Miratimeve të Vlerësuesit të kompetencës

Aplikimet për miratimet e vlerësuesit do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksin1 – Forma e aplikimit për lëshimin, Rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do t'i paraqitet AAC nëpërmjet formularit të aplikimit i cili do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:


- a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti), nëse është i nevojshëm;
- b. Liçencë KTA;
- c. Vërtetim i kalimit të suksesshëm të një kursi vlerësimi të miratuar (p.sh. certifikatë/diplomë) brenda një viti para aplikimit për vlerësues;
- d. Nivel imjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);
- e. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- f. Liçensa/certifikata radio-telefonike, nëse është e aplikueshme;
- g. Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është i aplikueshëm.

Me marrjen e plotë të dokumentave, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I-Pjesa KTA, KTA.C.055). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC lëshon miratimet e vlerësuesit në përputhje me modelin nga Aneksi 2 – liçensa KTA.

10.3 Vlefshmëria

Periodha e vlefshmërisë e një miratimi të vlerësuesit është 3(tre) vjet. Periodha e vlefshmërisë do të nisë jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të suksesshëm të vlerësimit.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

10.4 Rivlerësimi i Miratimeve të Vlerësuesit

Aplikimet për Rivlerësimin e miratimeve të vlerësuesit do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AAC në Aneksin 1 – Forma e aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do të paraqitet AAC-së jo më vonë se 7 ditë para datës së përfundimit të afatit të miratimit.

Formulari i aplikimit do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:

- a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti), nëse është i nevojshëm;
- b. Liçencë KTA;
- c. Vërtetim i përfundimit të suksesshëm të një trajnimi rifreskues të aprovuar mbi aftësitë vlerësuese (p.sh.certifikata/diploma) brenda periudhës vlefshmërisë;
- d. Vërtetim i përfundimit me sukses të një trajnimi të aprovuar mbi praktikat operacionale aktuale (p.sh.certifikata/diploma) brenda periudhës vlefshmërisë;
- e. Nivel i mjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);
- f. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- g. Vërtetim i pagimit të detyrimeve , nëse është i aplikueshëm.


Udhëzim

Një kopje e liçencës KTA kërkohet për të kontrolluar që:

- i. ka një miratim të njësisë të vlefshëm; dhe*
- ii. zotëruesi ka ushtruar privilegjet e liçensës tij KTA për një periudhë prej të paktën 2 vjet menjëherë para aplikimit për ASS. Kjo periudhë mund të shkurtrohet nga AAC kur kërkohet nga organizata e trajnimit, por nuk do të jetë më pak se një vit.*

Me marrjen e plotë të dokumentave, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I-Pjesa KTA, KTA.C.060). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do të dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC rivalidon miratimet e vlerësuesit në përputhje me modelin e Aneksit 2 – liçensa KTA.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

10.5 Rinovimi i Miratimeve të Vlerësuesit


Aplikimet për rinovimin e miratimeve të vlerësuesit do të bëhen duke përdorur formularin e mundësuar nga AACnë Aneksin 1 – Forma e aplikimit për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e liçensave, kategorive dhe miratimeve. Aplikimi do t'i paraqitet AAC-së jo me vonë se 7 ditë para datës së përfundimit të afatit të miratimit.

Formulari i aplikimit do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:

- a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti), nëse është i nevojshëm;
- b. Liçencë KTA;
- c. Vërtetim i përfundimit me sukses të një trajnimi rifreskues të aprovuar mbi aftësitë vlerësuese (p.sh. certifikata/diploma) brenda një viti pas aplikimit për rinovim;
- d. Vërtetim i përfundimit me sukses të një trajnimi të aprovuar mbi praktikën operacionale aktuale (p.sh. certifikata/diploma) brenda një viti para aplikimit për rinovim;
- e. Vërtetim i kalimit me sukses të një vlerësimi kompetence vlerësuesi brenda një viti para aplikimit për rinovim;
- f. Nivel i mjaftueshëm i aftësisë së gjuhës (p.sh. certifikatë);
- g. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- h. Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është i aplikueshëm.

Me marrjen e një grupi të plotë dokumentash, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I- Pjesa KTA, KTA.C.060). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC rinovon miratimet e vlerësuesit në përputhje me modelin nga Aneksi 2 – liçensa KTA. Periudha e vlefshmërisë do të nisë jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit me sukses të vlerësimit.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

11. AUTORIZIMETE PËRKOHSHME

11.1 Të përgjithshme

Autorizimet e përkohshme lëshohen nga AAC, bashkë edhe me një analizë parrezikshmërie të mundësuar nga OSHNA kur kërkesat specifike nuk mund të plotësohen.

Ekzistojnë dy autorizime të përkohshme që AAC mund të lëshojë: autorizim OJTI i përkohshëm; dhe autorizim vlerësuesi i përkohshëm.


Autorizimet e përkohshme nuk do të përfshihen në liçencën e KTA. Autorizime të tilla do të lëshohen si një dokument i veçantë duke përfshirë privilegjet e zotëruesit dhe vlefshmërinë e saj. Autorizimet e përkohshme mund të lëshohen duke përdorur modelin e Aneksit 3 – Autorizimet e përkohshme.

11.2 Autorizimi OJTI i Përkohshëm

11.2.1 Kushtet

Kur nuk është e mundur përputhja me kërkesat e parashikuara në Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, KTA.C.010(b)(2), AAC mund të lëshojë autorizim OJTI të përkohshëm për të mbuluar situata të veçanta (shikoni udhëzimin e mëposhtëm) bazuar në analizën e safety të prezantuar nga OSHNA.

Kërkesa KTA.C.010(b)(2) specifikon që “zotëruesit e një miratimi OJTI do të ushtrojnë privilegjet e miratimit vetëm nëse ato kanë ushtruar për një periudhë të paktën 6 muaj para privilegjin e miratimit të njësisë, në të cilin do të jepen instruksionet.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Udhëzim

Situatat e veçanta për të cilat konsiderohet si e pamundur për të qenë në përputhje me KTA.C.010(b)(2) për shkak të eksperiencës në miratimin e vlefshëm të njësisë, dhe, për këtë, mund të jepet një autorizim OJTI i përkohshëm, janë si mëposhtë:

- i. vendosja e një njësie të re KTA ose sektori të ri për ofruesin e shërbimit të lundrimit ajror;*
- ii. vazhdimësia e shërbimit ekzistues rrezikohet për shkak të mos-disponueshmërisë së personelit si pasojë e një ndryshimi në ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror në njësinë KTA;*
- iii. kategori të reja ose miratim kategorie të vëna në operim tek një njësi KTA;*
- iv. rihapja e një njësie KTA të përkohshme.*

Autorizimi OJTI i përkohshëm mund t'i lëshohet zotëruesit të një miratimi të vlefshëm OJTI i cili është lëshuar në përputhje me KTA.C.015 dhe procesin në Kapitullin 7 – miratimi OJTI i kësaj procedurë.


11.2.2 Lëshimi i Miratimeve OJTI të Përkohshme

Aplikimet për miratime OJTI të përkohshme do të bëhen nga organizata OSHNA/trajnuese me shkrim në AAC.

Çdo aplikim do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:

- a. Kopje e liçencës KTA;
- b. Analizë sigurie sipas kërkesës për autorizim të përkohshëm (shikoni §11.3.2 Lëshimi i Miratimit të Përkohshëm të Vlerësuesit dhe udhëzimi lidhur);
- c. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- d. Nivel i përshtatshëm i aftësisë gjuhës (p.sh. certifikatë);
- e. Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është i aplikueshëm.

Me marrjen e plotë të dokumentave , AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshtatshme (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I-Pjesa KTA, KTA.C.025). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

AAC lëshon miratimet e përkohshme OJTI në përputhje me modelin e Aneksit 2 – liçensa KTA. Periudha e vlefshmërisë do të nisë jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit me sukses të vlerësimit.

Udhëzim

Analizat e parrezikshmërisë duhet të specifikojë arsyet për të cilat kërkesat e miratimit të njësisë të parashikuara në KTA C.010(b)(2) nuk mund të plotësohet si dhe niveli ekuivalent i parrezikshmërisë do të sigurohet nga mënyra të tjera.

Autorizimi i përkohshëm OJT do të kufizohet nga instruksioni i nevojshëm për mbulimin e situatave të jashtëzakonshme.

11.2.3 Vlefshmëria e miratimit të përkohshëm OJTI

Vlefshmëria nuk do të kalojë një vit apo përfundimin e vlefshmërisë së miratimit OJTI lëshuar në përputhje me KTA.C.015, cilado ndodh më herët.

11.3 Autorizimi i Përkohshëm për Vlerësuesit e Kompetencës

11.3.1 Kushtet

Kur kërkesat e parashikuara në KTA.C.045 (d)(1) nuk plotësohen, AAC mund të autorizojë zotëruesit e një miratimi vlerësuesi lëshuar në përputhje me KTA.C.055 (dhe procesine Kapitullit 10 të kësaj procedure) për kryerjen e vlerësimeve referuar në KTA.C.045(b)(3) dhe (4) për të mbuluar situata të veçanta ose siguruar pavarësinë e vlerësimit, me kusht që të plotësohen kërkesat e përcaktuara në pikat KTA.C.065(b) dhe (c).


KTA.C.045 (d)(1) specifikon që:

“(d) Si shtesë për kërkesat e vendosura në pikën (c), zotëruesit e një miratimi vlerësuesi do të ushtrojnë vetëm privilegjet e miratimit:

(1) për vlerësime që të çojnë në lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e një miratimi njësi, nëse ato zotërojnë gjithashtu miratimin e njësisë të lidhur me vlerësimin për një periudhë prej të paktën një viti,”

KTA.C.045 (b)(3) dhe (4) specifikojnë që:

“(b) Zotëruesit e një miratimi të vlerësuesit janë të autorizuar të zbatojnë vlerësime të:

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

(3) student kontorollorëve të trafikut ajror për lëshimin e një miratimi të njësi së dhe miratimeve të kategorive, nëse është i aplikueshëm;

(4) kontrollorëve të trafikut ajror për lëshimin e një miratimi të njësisë dhe miratimeve të kategorive, nëse është e aplikueshme, gjithashtu edhe për rivlerësimin dhe rinovimin e një miratimi njësi;”

KTA.C.065 (b) dhe (c) specifikojnë që:

“(b) Me qëllim mbulimin e situatave të veçanta zotëruesi i miratimit të vlerësuesit do të zotërojë gjithashtu një miratim njësie me kategorinë e lidhur me të dhe, nëse është e aplikueshme, miratim të kategorisë, të lidhur me vlerësimin për një periudhë menjëherë para të paktën një viti.


(c) Me qëllim sigurimin e pavarësisë së vlerësimit për arsye të natyrës përsëritëse zotëruesi i miratimit vlerësuesit duhet të zotërojë gjithashtu një miratim njësi me kategorinë e lidhur dhe, nëse është i aplikueshëm, miratim kategorie, lidhur me vlerësimin për një periudhë prej të paktën një viti.

Udhëzim

Situata të veçanta për të cilat mund të konsiderohet e pamundur përputhja me KTA.C.045(d)(1) që lidhet me eksperiencën e miratimit të njësisë, dhe, si pasojë, mund të jepet një autorizim i përkohshëm vlerësuesi, jepen si më poshtë:

- i. krijimi një njësie ATC të re apo sektori të ri për ofruesin e shërbimit të lundrimit ajror;
- ii. vazhdueshmëria e shërbimit ekzistues rrezikohet për shkak të mos-disponueshmërisë së personelit si pasojë e një ndryshimi në ofruesin e shërbimit të lundrimit ajror në njësinë ATC;
- iii. kategori të reja ose miratime kategorie të vëna në operim tek një njësi ATC;
- iv. ribapja e një njësie ATC të përkohshme.

Në rastin e njërive që nuk kanë numër të mjaftueshëm vlerësuesish apo nëse pavarësia dhe objektiviteti i vlerësimit nga procesi i trajnimit është afektuar, mund të jepet një autorizim i përkohshëm i vlerësuesit.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Për lëshimin e autorizimit të përkohshëm të vlerësuesi, AAC mund t'i kërkojë OSHNA të sigurojë një analizë parrezikshmërie (shikoni §11.3.2 Lëshimi i Miratimit të Përkohshëm të Vlerësuesit dhe udhëzimet e lidhura me të).

11.3.2 Lëshimi i Miratimeve të Përkohshmeve të Vlerësuesit

Aplikimi për miratimet e përkohshme të vlerësuesit do të bëhet nga OSHNA me shkrim në AAC.

Çdo aplikim do të shoqërohet nga dokumentat e mëposhtëme:

- a. Kopje e liçencës KTA;
- b. Analizë parrezikshmërie sipas kërkesës për autorizim të përkohshëm, nëse kërkohet nga AAC;
- c. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- d. Nivel i përshtatshëm i aftësisë gjuhës (p.sh. certifikatë);
- e. Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është i aplikueshëm.

Me marrjen e plotë të dokumentacionit, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I-Pjesa KTA, KTA.C.065). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.


AAC lëshon autorizimet e përkohshme të vlerësuesit në përputhje me modelin e Aneksit 2 – liçensa KTA.

Udhëzim

Analiza e parrezikshmërisë, në rast se kërkohet, duhet të specifikojë arsyet për të cilat kërkesa e miratimit të njësisësiç parashikohen në KTA.C.045 (d)(1) nuk mund të plotësohen dhe se si niveli ekuivalent i parrezikshmërisë do të sigurohet nga mënyra të tjera.

Për qëllimin e sigurimit të pavarësisë së vlerësimit për arsye të natyrës së përsëritur, analiza e parrezikshmërisë duhet të përfshijë natyrën e përsëritur të nevojës për të siguruar pavarësinë e vlerësimit nga procesi i trajnimit dhe të mundësojë një bazë për lëshimin e autorizimeve të përkohshme të shumëjshhta bazuar në të njëjtën arsye.

Për qëllimin e mbulimit të situatave të veçanta zotëruesi i miratimit të vlerësuesit, autorizimi i përkohshëm i vlerësuesit të do të kufizohet nga sqarimi i nevojshëm për të mbuluar situatat e veçanta.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

11.2.3 Vlefshmëria e Miratimeve të Përkohshme të Vlerësuesit

Për qëllimin e mbulimit të situatave të veçanta, vlefshmëria e autorizimit nuk do të kalojë një vit ose vlefshmërinë e miratimit vlerësuesit të lëshuar në përputhje me KTA.C.055 (shikoni Kapitulli 10 – Miratimi i Vlerësuesit), cilido të ndodhë më parë.

Për qëllimin e sigurimit të pavarësisë të vlerësimit për arsye të natyrës së përsëritur, vlefshmëria e autorizimit do të përcaktohet nga AAC, por nuk do të kalojë vlefshmërinë e miratimit të vlerësimit të lëshuar në përputhje me KTA.C.055 (shikoni Kapitulli 10 – Miratimi i vlerësuesit).

12. SHKËMBIMI I LIÇENSAVE


12.1 Të përgjithshme

Nëse zotëruesi i liçencës do të ushtrojë privilegjet e liçencës në Republikën e Shqipërisë dhe ka një liçencë të lëshuar nga AAC e një Shteti anëtar, zotëruesi i liçencës duhet të paraqesë një kërkesë për të shkëmbyer liçencën e tij/saj në përputhje me këtë procedurë.

Shkëmbimi i liçencës do të paraqitet në përputhje me këtë procedurë, përveç rasteve kur janë vendosur marrëveshje të tjera midis Shteteve të përfshira.

Republika e Shqipërisë duhet të njohi:

- liçensat e kontrollorit të trafikut ajror dhe student kontrollorit të trafikut ajror, duke përfshirë kategoritë e tyre, miratimet e kategorive, instruktorin e trajnimit në vendin e punës (OJTI), instruktorin pajisjes trajnuese sintetike (STDI) dhe miratimet e vlerësuesit, gjithashtu edhe miratimet e aftësisë së gjuhës dhe çertifikatat mjekësore të lëshuara nga Shtete anëtar në përputhje me Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, ATCO.A.10*
- çertifikatat e organizatave të trajnimit të kontrollorëve të trafikut ajror, ekzaminuesit aero-mjekësore dhe qendrat aero-mjekësore të lëshuara nga Shtete anëtare në përputhje me këtë rregullore; dhe*
- çertifikatat e përfundimit të kurseve trajnuese të lëshuara nga organizata trajnuese të aprovuara nga Shtete anëtare që çojnë në plotësimin e kategorive, miratimeve dhe/ose liçencën e student kontrollorit të trafikut ajror referuar në paragrafin (a).*

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

12.2 Kushtet për Shkëmbimin e Liçensave

Liçensat duhet të shkëmbehen vetëm në rastet ku është e sigurtë që zotëruesi i liçencës do të ushtrojë privilegjet e liçensës në Republikën e Shqipërisë.

Për këtë qëllim, dhe me synim parandalimin e detyrimit administrativ të panevojshëm, AAC do t'i kërkojë zotëruesit të liçensës, bashkë me aplikimin për shkëmbim, për të provuar që ai/ajo do të marrë një trajnim njësie nga një organizatë trajnimi e miratuar e cila do t'a lejojë atë të ushtrojë privilegjet e liçensës në Republikën e Shqipërisë. Si pasojë, shkëmbimi i liçensave do të ndodhë vetëm kur organizata e trajnimit ka paraqitur një trajnim njësie për aprovim.

12.3 Shkëmbimi i informacionit ndërmjet AAC/ AKM-ve

AAC mund të kërkojë informacionin e mëposhtëm nga shtetet që kanë lëshuar liçensën:


- a. Llojin e trajnimit që mbajtësi i liçensës ka kryer gjatë karrierës së tij, duke përfshirë certifikatat e Organizatës së Trajnimit.
- b. Informacion në lidhje me pezullimet, revokimet ose limitimet e liçensës.
- c. Historikun mjekësor.
- d. Certifikatat e lëshuara nga AME ose AMC.
- e. Historikun e liçensimit.
- f. Metodologjinë e vlerësimit gjuhësor
- g. Gjetjet e 5 viteve të fundit në lidhje me trajnimet, certifikatat mjekësore dhe aftësisë gjuhësore, nëse ka.

12.4 Shkëmbimi i një Liçense KTA

Aplikimet për shkëmbimin e një liçence KTA do të bëhen nga individë me shkrim pranë AAC.

Çdo aplikim do të jetë i shoqëruar nga dokumentat e mëposhtëm:

- a. Liçencë KTA e vlefshme;
- b. Një certifikatë mjekësore e vlefshme e klasës 3;
- c. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti);
- d. Nivel imjaftueshëm i aftësisë së gjuhës angleze (p.sh. certifikatë);
- e. Vërtetim i pagimit të detyrimeve, nëse është e aplikueshme.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Për të garantuar që zotëruesi i liçencës do të ushtrojë privilegjet e liçensës brenda njësive ATC të menaxhuara nga OSHNA, organizata OSHNA/trajnuese do të paraqesë dhe *një plan trajnimi njësie në të njëjtën kohë me aplikimin për shkëmbimin e liçencës për të përfituar miratimin/et e njësisë.*

Me marrjen e plotë të dokumentacionit, AAC do të verifikojë nëse plotësohen gjithë kërkesat e përshkruara (ref. *me* Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I-Pjesa KTA, KTA.A.010). Nëse dokumentat e paraqitura nuk plotësojnë kërkesat e aplikimit, AAC do t'i dërgojë një njoftim aplikantit dhe OSHNA duke shpjeguar arsyet e mospërputhjes.

AAC do të shkëmbejë liçencën duke lëshuar një të re në përputhje me modelin nga Aneksi 2 – Liçensa KTA, e cila do të përfshijë kategoritë, miratimet e kategorive, miratimet e liçensave dhe gjithë miratimet e njësive të vlefshme në liçencën e mëparshme, duke përfshirë datën e lëshimit të parë dhe të përfundimit, nëse është i aplikueshëm.

Pas shkëmbimit të liçencës së KTA, AAC do të miratojë apo refuzojë kursin e miratimit të njësisë të vendosur në përputhje me KTA.B.020(b) dhe (c) jo më vonë se 6 (gjashtë) javë pas prezantimit të kërkesës për miratim të kursit (ref. procedura e AAC për Certifikimin e organizatës trajnuese dhe miratimin e kurseve).

Pas marrjes së liçencës së re, zotëruesi do të veprojë në përputhje me procedurat në Kapitullin 2 – Lëshimi liçencës KTA për kategoritë e reja, miratimin e kategorive, miratimin e liçencës dhe miratimin njësisë.


Pas shkëmbimit të liçencës, AAC do t'i kthejë autoritetit të lëshimit liçensën e mëparshme.

13. ANULIMI DHE PEZULLIMI I LIÇENSAVE, KATEGORIVE DHE MIRATIMEVE

13.1 Të përgjithshme

Liçensat, kategoritë dhe miratimet mund të pezullohen ose anulohen nga AAC kur zotëruesi i liçencës nuk përputhet me kërkesat e Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019,, Pjesa KTA.ARD.005.

Kur zotëruesit të liçensës i revokohet liçensa e tij/saj, ai/ajo duhet t'i kthejë menjëherë liçensën AAC.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

AAC do të analizojë me kujdesin e duhur çdo situatë të prezantuar apo të zbuluar gjatë aktiviteteve mbikëqyrëse për të përcaktuar anulimin apo revokimin e liçencës, kategorive dhe miratimeve. AAC mund t'i kërkojë OSHNA të prezantojë prova shtesë për një qartësim më të mirë të situatës të zbuluar gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes.

13.2 Kushtet për Anulimin

AAC do të pezullojë apo anulojë një liçencë, kategori apo miratim në përputhje me Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi II – Pjesa KTA.AR, KTA.AR.C.010, në veçanti në rrethanat e mëposhtëme:


- a. ushtrimi i privilegjeve të liçencës kur zotëruesi i liçencës nuk përputhet më me kërkesat e aplikueshme të Nr. 91, Datë 21.02.2019, KTA.A.015
- b. pajisja me një liçencë student kontrollori trafiku ajror apo kontrollori trafikut ajror, miratimi apo certifikate nga falsifikimi i dokumentave të paraqitura;
- c. falsifikimi i liçensës apo të dhënave të certifikatës;
- d. ushtrimi i privilegjeve të liçencës, kategorisë/ve ose miratimit/eve nën ndikimin e substancave psikoaktive;
- e. me kërkesë të zotëruesit të liçencës.

AAC mund të pezullojë apo anulojë liçencën, kategorinë apo miratimin, kur identifikohet një çështje parrezikshmërie gjatë aktiviteteve mbikëqyrëse ose nga mënyra të tjera ku janë gjetur prova për mospërputhje me Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, dhe/ose këtë procedurë. Një vendim lidhur me pezullimin ose anulimin e liçensës, kategorisë/ve ose miratimit/eve do të merret nga AAC bazuar në çështjen e parrezikshmërisë të identifikuar.

AAC mund të pezullojë liçensën në rastin e paaftësisë përkohshme në përputhje me procedurat e referuara në Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I – Pjesa KTA, KTA.A.015(e). Një vendim lidhur me pezullimin e liçensës do të përcaktohet në bashkëpunim me OSHNA, duke marrë në konsideratë arsyet për deklarimin e paaftësisë të përkohshme.

13.2.1 Proçesi për Anullim si dhe e Drejta për Apelim

Kur një liçencë është anuluar, zotëruesi duhet ta kthejë atë tek AAC.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Në rastet e anulimit të liçensave, kategorive dhe miratimeve, AAC do të informojë zotëruesit e liçencës dhe OSHNA me shkrim mbi vendimin dhe të drejtën e tyre për të apeluar. Kjo do të mbartet në një dokument të firmosur nga titullari i AAC-së brenda 48 orëve nga vendimi për të pezulluar apo anuluar liçensën e një zotëruesi, kategorinë/të apo miratimin/et. Anulimi do të nisë 24 orë pas lëshimit të dokumentit nga AAC.

Udhëzim

Gjithë vlerësimet pasuese të kryera nga ata që kanë një miratim vlerësuesi të pezulluar apo anuluar bëhen të pavlefshme. OSHNA do të marrë masat e duhura për të përjashtuar persona të tillë nga procesi i vlerësimit. AAC mund të verifikojë që vlerësimet nuk mbarten nga vlerësues të pezulluar apo të anuluar.

Brenda 5 ditëve nga marrja e dokumentit të anulimit nga AAC, zotëruesi i liçensës mund të apelojë vendimin e AAC lidhur me anulimin e liçensës, kategorisë/ve ose miratimit/eve. Kjo do të bëhet me shkrim dhe do të përfshijë, si minimum, dokumentat e mëposhtëm:

- a. Referencë për dokumentin e AAC-së;
- b. Arsyeja për apelim; dhe
- c. Adresë për komunikim të mëtejshëm.


Brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës së apelimt, AAC do të mundësojë një përgjigje të shkruar për zotëruesin e liçencës me një nga mundësitë e mëposhtëme:

- të mbajë anulimin dhe të japë këshilla të mëtejshme për:
 - kushtet që duhen plotësuar për të hequr anulimin;ose
 - liçensa do t'i kthehet AAC –së brenda 3 ditëve nga marrja e përgjigjes.

13.3 Kushtet për Pezullim

AAC do të pezullojë një liçencë, kategori apo miratim në përputhje me Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, AneksiII – Pjesa KTA.AR, KTA.AR.C.010, në veçanti në rrethanat e mëposhtëme:

- a. ushtrimi i privilegjeve të liçencës kur zotëruesi i liçencës nuk përputhet më me kërkesat e aplikueshme të Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019,

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

- b. pajisja me një liçencë student kontrollori trafiku ajror apo kontrollori trafiku ajror, miratimi apo certifikate nga falsifikimi i dokumentave të paraqitura;
- c. falsifikimi i liçencës apo të dhënave të certifikatës;
- d. ushtrimi i privilegjeve të liçencës, kategorisë/ve ose miratimit/eve nën ndikimin e substancave psikoaktive;
- e. me kërkesë të zotëruesit të liçencës.


AAC mund të pezullojë liçensën, kategorinë apo miratimin, kur identifikohet një çështje parrezikshmërie gjatë aktiviteteve mbikëqyrëse ose nga mënyra të tjera ku janë gjetur prova për mospërputhje me Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, dhe/ose këtë procedurë. Një vendim lidhur me pezullimin e liçencës, kategorisë/ve ose miratimit/eve do të merret nga AAC bazuar në çështjen e parrezikshmëritë identifikuar.

AAC mund të pezullojë liçensën në rastin e paaftësisë përkohshme në përputhje me procedurat e referuara në Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Aneksi I – Pjesa KTA, KTA.A.015(e). Një vendim lidhur me pezullimin e liçensës do të përcaktohet në bashkëpunim me OSHNA, duke marrë në konsideratë arsyet për deklarimin e paaftësisë të përkohshme .

13.3.1 Proçesi për Pezullimin si dhe e Drejta për Apelim

Një pezullim do të përfundojë kur kushtet që të drejtonin tek situata kanë përfunduar. Kur një liçensë është anuluar, zotëruesi duhet ta kthejë atë tek AAC.

Në rastet e pezullimit të liçensave, kategorive dhe miratimeve, AAC do të informojë zotëruesit e liçencës dhe OSHNA me shkrim mbi vendimin dhe të drejtën e tyre për të apeluar. Kjo do të mbartet në një dokument të firmosur nga titullari i AAC brenda 48 orëve nga vendimi për të pezulluar apo anuluar liçensëne një zotëruesi, kategorinë/të apo miratimin/et. Pezullimi do të nisë 24 orë pas lëshimit të dokumentit nga AAC.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Udhëzim

Gjithë vlerësimet pasuese të kryera nga ata që kanë një miratim vlerësuesi të pezulluar apo anuluar bëhen të pavlefshme. OSHNA do të marrë masat e duhura për të përjashtuar persona të tillë nga procesi i vlerësimit. AAC mund të verifikojë që vlerësimet nuk mbarten nga vlerësues të pezulluar apo të anuluar.

Brenda 5 ditëve nga marrja e dokumentit të pezullimit nga AAC, zotëruesi i liçencës mund të apelojë vendimin e AAC lidhur me pezullimin ose anulimin e liçensës, kategorisë/ve ose miratimit/eve. Kjo do të bëhet me shkrim dhe do të përfshijë, si minimum, dokumentat e mëposhtëm:

- a. Referencë për dokumentin e AAC-së;
- b. Arsyeja për apelim; dhe
- c. Adresë për komunikim të mëtejshëm.

Brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës së apelit, AAC do të mundësojë një përgjigje të shkruar për zotëruesin e liçensës me një nga mundësitë e mëposhtme:

- a. të mbajë pezullimin dhe të japë këshilla të mëtejshme për:
 - i. kushtet që duhen plotësuar për të hequr pezullimin; ose
 - ii. liçensa do t'i kthehet AAC –së brenda 3 ditëve nga marrja e përgjigjes.
- b. të heqë pezullimin, por në këtë rast zotëruesi i liçencës do të këshillohet që të mund të rifillojë detyrat e tij. Një kopje e këtij dokumenti do t'i përcillet OSHNA që të lejojnë KTA të rifillojnë aktivitetet.


14. ZËVËNDËSIMI I NJË LIÇENCE KTA

AAC zëvendëson liçencën e KTA-ve nëse është e nevojshme për arsye administrative dhe kur pika (XIIa) e liçencës plotësohet dhe nuk mbetet më hapësirë.

Arsyet administrative që konsiderohen për zëvendësimin e liçensave të KTA janë si vijon, por nuk janë të kufizuara nga humbja, ose dëmtim i madh që çon në palexueshmëri.

Udhëzim

Arsye administrative shitesë mund të përfshihen në të ardhmen bazuar në eksperiencën e fituar nga kërkesat e zotëruesve të tjerë.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Aplikimet për zëvendësimin e liçencës KTA do të bëhen nga çdo individ me shkrim për AAC, duke treguar arsyen për zëvendësimin. Në rastin kur arsyeja për zëvendësimin e liçencës KTA nuk është e listuar më sipër, AAC do të analizojnë rastin dhe do të japë vendimin e saj për mbajtësin brenda 72 orëve nga marrja e kërkesës. Sapo AAC vendos të zëvendësojë liçencën e KTA, do të kërkohet nga zotëruesi i liçencës vërtetimin e pagesës së detyrimeve (mbajtësi i liçensës do të paguajë kostot administrative).

AAC lëshon liçensën në përputhje me modelin nga Aneksit 2 – Liçensa KTA. Data e lëshimit të parë të kategorive dhe miratimeve të kategorisë do të transferohet në liçensën e re.


15. MBAJTJA E REKORDEVE

AAC mban një listë të të gjithë certifikatave të organizatave dhe liçensave dhe certifikatave të personelit që ato lëshojnë. Kjo përfshin:

- a. detaje të kurseve të mundësuar nga organizatat e trajnimit;
- b. proceset për lëshimin e liçensave, kategorive, miratimeve dhe certifikatave, dhe për mbikëqyrjen e vazhdueshme të zotëruesve të këtyre liçensave, kategorive, miratimeve dhe certifikatave;
- c. mbikëqyrja e vazhdueshme e personave dhe organizatave që ushtrojnë aktivitetet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë por të certifikuar nga Autoritetet e një Shteti tjetër,
- d. gjetjet, veprime korigjuese dhe data e mbylljes veprimeve;
- e. masa të marra zbatuese;
- f. informacion parrezikshmërie dhe masat ndjekëse.

Të dhëna të tilla mund të mbahen ose në letër ose në format elektronik (ose të dyja). Gjithë të dhënat mbahen për një periudhë minimale prej 5 vjetësh. Rekordet në lidhje me liçensat e personelit mbahen për një periudhë minimale prej 10 vjetësh pas përfundimit të miratimit të fundit në liçencë*.

**kjo duhet të adresohet në lidhje me ligjin kombëtar të mrojtes të të dhënave ku mund të vendosen periudha të ndryshme të kohës. Në rastin kur ligji kombëtar kërkon më pak se 5 dhe 10 vjet, AAC mund të organizojë ruajtjen e rekordeve për periudhën shtesë. Në rastin kur ligji kombëtar kërkon më shumë se 5 dhe 10 vjet, AAC do të ndjekë kërkesat e mundësuar nga ligji kombëtar.*

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

16. ÇERTIFIKATAT MJEKËSORE

16.1 Të përgjithshme

Mbajtësit e liçensave të kontrollorit të trafikut ajror dhe student kontrollorit të trafikut ajror iu kërkohet që të kenë një standart minimal të shëndetit mjekësor për të garantuar që ata janë të aftë për të ofruar një shërbim KTA dhe për të minimizuar, për aq sa është e mundur, rrezikun që ata mund të bëhen papritur të paaftë deri në atë shkallë sa që mund të dëmtojnë sigurinë e operimit të një avioni.

Autoritetit të Aprovuar Aeromjekësor do t'i kërkohet të zbatojë kriteret e përgjithshme të ICAO dhe standartet minimale mjekësore sipas Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019,

Për të rinovuar ose marrë një certifikate mjekësore të re aplikanti është i detyruar të kryejë teste mjekësore me qëllim ruajtjen e shëndetit të tij mjekësor.


1. Certifikata mjekësore që nevojitet për licensën e KTA jepet nga një qender Aeromjekësore (AeMC) ose nga një AME i autorizuar, sipas udhëzimeve të AAC.
2. Certifikata mjekësore duhet të rinovohet:
 - a) çdo 2 vjet për moshën nën 40 vjet,
 - b) çdo vit për moshën mbi 40 vjet

16.2 Mbajtësit e liçensave të kontrollorit të trafikut ajror dhe student kontrollorit të trafikut ajror

16.2.1 Kërkesa

Një kontrollor i trafikut ajror nuk duhet të lejohet të ofrojë një shërbim kontrolli trafiku ajror po të mos mbajë një certifikatë të vlefshme mjekësore të kategorisë përkatëse.

Një student kontrollor i trafikut ajror ose një kontrollor në trajnim i trafikut ajror nuk duhet të ofrojë një shërbim kontrolli trafiku ajror nën mbikëqyrje po të mos mbajë një certifikatë të vlefshme mjekësore të kategorisë përkatëse.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Mbajtësi i një liçense student kontrollori i trafikut ajror ose të kontrollorit të trafikut ajror që dështon në ekzaminimin mjekësor nuk duhet të lejohet të ofrojë një shërbim kontrolli trafiku ajror edhe pse çertifikata e vlefshme mjekësore e mëparshme e tij mund të mos ketë skaduar.

Mbajtësi i një liçense student kontrollori i trafikut ajror ose të kontrollorit të trafikut ajror që dështon në një ekzaminim mjekësor ose ka ndonjë kufizim mjekësor ose kushte të vendosura në çertifikatën e tij mjekësore, duhet të njoftojë menaxhmentin e Njesisë.


Një mbajtës liçense që bëhet i vetëdijshëm mbi rëniene shëndetit të tij mjekësor, e cila e bën atë të paaftë për të ushtruar në mënyrë të sigurtë privilegjet e liçensës së tij duhet të informojë menaxhmentin e Njesisë.

Menaxhmenti i Njesisë duhet të informojë menjëherë OSHLA dhe Autoritetin e Licensimit kur një mbajtës liçense vlerësohet si i paaftë nga ana mjekësore për të ofruar një shërbim KTA.

Ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror duhet të ndërtojë procedura për të administruar ndikimet operacionale në rastet e rënies së shëndetit mjekësor dhe të informojë Autoritetin e Aviacionit Civil kur një mbajtës liçense është vlerësuar i papërshtatshëm nga ana mjekësore.

Proçedurat e mesiperme duhet të aprovohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

1. Personat që kërkojnë licencë KTA ose Student KTA duhet ti japin çdo informacion të nevojshëm mbi shëndetin e tyre, ekzaminuesve mjekësore për marrjen e certifikates mjekësore.
2. KTA i licensuar në çdo vizitë duhet të deklarojë çdo sëmundje ose demtim që e kane ndaluar atë që të ushtrorë në mënyrë të përkohshme privilegjet e liçensës.
3. AAC, nëpërmjet Qendrave Aeromjekësore dhe ekzaminesve të Autorizuar (AME), mund të marrë çdo informacion shtesë që e shikon të dobishëm për qellimin e certifikimit, edhe pa patur konsensusin e aplikantit.
4. AAC, për të mbrojtur parrezikshmerrinë e navigimit ajror si dhe kur ka dyshime për shëndetin fizik dhe mendor, nëpërmjet Qendrave Aeromjekësore dhe ekzaminesve të Autorizuar (AME):

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

- a) I kërkon të licensuarit të ndërmarrë teste mjekësore shtesë.
- b) Kufizon, revokon ose ndalon certifikaten mjekësore, duke njoftuar për vendimin personin dhe organizaten ku personi operon.
- c) Çdo test shtesë mund të kërkohet në çdo moment nëqoftese shihet e arsyeshme nga AME dhe AeMC. Nqs aplikanti refuzon të kryejë këto teste nuk do ti jepet certifikata mjekësore ose do ti pezullohet ajo aktuale. Kur një certifikatë mjekësore pezullohet për shkak të një dëmtimi ose sëmundje personale, AAC informon mbajtësin e licenses. (Testet shtesë mund të kërkojnë edhe nga AAC në rast se gjatë një inspektimi apo auditit dyshohet që një mbajtës license KTA nuk është në gjëndje të mirë fizike a mendore).

Udhëzim Vetë mbajtësit e liçensës janë përgjegjës për të garantuar që ata mbajnë një certifikatë të vlefshme mjekësore dhe duhet të përgjigjen për marrjen e masave për ekzaminimet e tyre fillestare dhe rinovuese mjekësore. Megjithatë, njësitë operationale duhet të kenë procedura për njoftuar mbajtësit e liçensës që kanë për të rinovuar dhe për të kryer ekzaminimet mjekësore. Mbajtësit e liçensave të kontrollorit të trafikut ajror duhet të kenë **Çertifikatën Mjekësore Evropiane Klasi 3 ose ICAO klasi 3** të rinovuar sipas afateve kohore përkatëse bazuar në moshën e kontrollorëve të trafikut ajror, si vijon:


- a) Kur mbajtësi i liçensës së kontrollorit të trafikut është deri 40 vjeç rinovimi i certifikatës mjekësore do të kryhet çdo 2 (dy) vjet.
- b) Kur mbajtësi i liçensës së kontrollorit të trafikut e ka kaluar moshën 40 vjeç rinovimi i certifikatës mjekësore do të kryhet çdo vit.

Autoriteteve Aeromjekësore mund t'i kërkojnë ekzaminime mjekësore shtesë sipas zgjedhjes së tij.

Aplikimi për certifikatë mjekësore do të kryhet sipas formatit të dhënë në Shtojcën 4.

Ekzaminimet mjekësore nuk do kryhen më vonë se 7 ditë nga data e skadencës së certifikatës së mëparshme.

Në raste të veçanta dhe të argumentuara nga OSHNA mund të ndryshohet ky afat, gjithnjë me miratimin e AAC.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

Qendrat Aeromjekesore (AeMC), dhe ekzaminuesit e autorizuar (AME) të cilët kryejnë vizita fizike dhe mendore dhe që kanë përgjegjësitë e tyre, duhet që në çdo kohë të sigurojnë konfidencialitetin.

16.3 Plagosje, Sëmundje dhe Shtatëzania, Rënia e Shëndetit

16.3.1 Kërkesa

Vlefshmëria e certifikatës mjekësore të një mbajtësi license që vuan një dëmtim personal ose sëmundje që përfshin paaftësinë, do të konsiderohet e pezulluar dhe mbajtësi i licensës ose OSHNA duhet të informojë Qendrën Aeromjekësore dhe AAC për situatën e tij.


Një grua që ka arsye të besojë se ajo është shtatëzanë duhet të informojë Qendrën Aeromjekësore.

Autoriteti Aeromjekësor duhet të vendosë disa kushte ose kufizime që ai i konsideron të përshtatshme për certifikatën mjekësore dhe mbajtësi i certifikatës mjekësore nuk duhet të ofrojë një shërbim kontrolli trafiku ajror po të mos përputhet me ato kufizime apo kushte të imponuara.

1. Mbajtësi i një certifikate mjekësore nuk duhet të ushtrojë privilegjet e licensës kur ka renie të shëndetit që mund të bëjë ata të mos ushtrojnë në siguri privilegjet e tyre.
2. Kjo në veçanti kur:
 - a) Kur ka një deficiente mentale ose fizike që nuk e lejon të kryejë në parrezikshmeri aktivitetet lidhur me licensën.
 - b) Kur ata kanë marrë substanca psikoaktive ose mjekime që e shtojnë rrezikun e paaftësisë për të vepruar në parrezikshmeri detyrat sipas licensës.
3. Mbajtësi i një license që vuan nga sëmundje të cilat bëjnë të pamundur kryerjen e aktiviteteve si KTA, duhet pa vonesë të njoftojë OSHLA-në e cila duhet të tërheqë ata nga detyra.

Si shtesë për raste të tilla mbajtësi i licensës duhet të dërgohet për egzaminime mjekësore shtesë. Rastet mund të jenë si më poshtë:

 - a) Shtrim spitalor për më shumë se 12 ore.
 - b) Operacion, ose procedurë lidhur me të.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

- c) Fundi i periudhes së një sëmundje që ka zgjatur më shume se 21 ditë.
- d) Përdorimi i drogave.
- e) Përdorimi dhe abuzimi me substancat psikoaktive ose alkoli të cilat e shtojnë rriskun dhe paaftesine për të performuar në parrezikshmeri privilegjet e licensës.

16.3.2 Udhëzim

Kur një çertifikatë mjekësore është pezulluar për shkak të plagosjeve ose sëmundjeve personale, AAC ose AME duhet të informojë mbajtësin e liçensës për kushtet dhe procedurat që mbajnë pezull atë.

Çdo kufizim apo kusht i imponuar duhet të tregohet qartë në çertifikatën mjekësore deri në atë shkallë sa që menaxhmenti i Njesisë mund të tregojë nga çertifikata mjekësore nëse kontrollori në fjalë është në përputhje me ato kufizime apo kushte.

Shënim: Shëmbulli i një kushti të shënuar në një çertifikatë mjekësore do të ishte që një kontrollori t'i kërkohej të mbante syze korrigjues.

16.3 Substancat Psikoaktive (pjetet alkoolike dhe drogat dhe medikamentet problematike)


Një kontrollor i trafikut ajror që po ofron një shërbim kontrolli trafiku ajror ndërsa është nën influencën e substancave psikoaktive mund të mos jetë i vetëdijshëm që shkalla e gjykimit dhe aftësitë e tij kanë degraduar deri në atë masë sa që shërbimi i ofruar prej tij është i pasigurtë. Ky mund të jetë rasti kur është abuzuar me substancat psikoaktive ose kur medikamentet janë rekomanduar nga një mjek, ose medikamentet janë marrë pa rekomandimin e mjekut për një ç'rregullim të vogël.

OSHNA duhet të ketë procedura për monitorimin e substancave psikoaktive .

16.4.1 Kërkesa

Mbajtësi i një liçense student kontrollori trafiku ajror ose kontrollori trafiku ajror nuk duhet të ofrojë një shërbim kontrolli trafiku ajror ndërsa është nën influencën e substancave psikoaktive (alkoole, droga dhe simulantë të ndryshëm psikoaktivë), duke përfshirë ndonjë medikament, që mund të ketë influenca negative mbi aftësinë e tyre për të ofruar një shërbim kontrolli trafiku ajror të sigurtë.

Është përgjegjësi e vetë mbajtësit të liçensës së student kontrollorit të trafikut ajror ose të kontrollorit të trafikut ajror për të garantuar që ata nuk marrin medikamente

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

para ose gjatë ofrimit të një shërbimi kontrolli trafiku ajror, të cilat do të kishin efekte të dëmshme mbi performancën e tyre operacionale. Autoriteti i Liçensimit nëpërmjet Autoritetit Aeromjekësor duhet të garantojë dhe të vendosë nëse mbajtësit e liçensës duhet apo nuk duhet të ofrojnë një shërbim KTA ndërsa janë nën një trajtim specifik mjekësor.

Menaxhmenti i Njesisë duhet të ketë të ndërtuar një proces të miratuar nga AKM për monitorimin e kontrollorëve për abuzime me substancat psikoaktive. Një kontrollor që dyshohet të jetë nën influencën e substancave psikoaktive menjëherë duhet të tërhiqet nga pozicioni operacional dhe të njoftohet menjëherë Autoriteti i Liçensimit dhe Autoriteti Aeromjekësor për atë ç'ka ka ndodhur.

16.4.2 Udhëzim


Autoriteti Aeromjekësor duhet të përcaktojë dispozita për t'i krijuar mundësi mbajtësve të liçensës për të kërkuar këshilla dhe/ose për marrë informacion në formën e Qarkoreve Mjekësore Aeronautike se cilat medikamente të rekomandueshme dhe të parekomandueshme do të ose ka të ngjarë të, dëmtoj aftësitë e tyre deri në atë shkallë sa që ata të mos jenë në gjendje të ofrojnë një shërbim kontrolli trafiku ajror.

Autoriteti Aeromjekësor ndërton procese dhe procedura për monitorimin e kontrollorëve për abuzim me pije alkoolike dhe droga të ndryshme, duke iu referuar ICAO Doc. 9654-AN/945 'Manuali mbi Parandalimin e Përdorimit të Substancave Problematike në Vendin e Punës në Aviacion' (1995).

16.5 Apelimi kundër ekzaminimit mjekësor

Apelimi kundër ekzaminimit mjekësor mund të kërkohet nga një KTA dhe të drejtohet AAC sipas rasteve më poshtë.

1. Rastet e vecanta kur rivlerësohet ekzaminimi mjekësor
 - a) Mbajtësit e liçensave që janë shpallur jo të përshtatshëm në mënyrë definitive, mund të kërkojnë AAC të bëjë një rishikim të ekzaminimit mjekësor. Nëqë ndonjë element i ri ka ndryshuar në shëndetin e tyre mjekësor, ose kur rregulloren të reja kanë hyrë në fuqi.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

b) Rishikim mund të kërkohet maksimumi 3 here dhe jo më pak se dy vjet nga kërkesa paraardhëse.


Rishikimi i vleresimit mjekesor kryhet nga AME-të e autorizuar. Në këtë rast kërkesat mjekesore do të jenë si të një rasti fillestar aplikimi.

2. Në rastet kur aplikanti ka kundërshti për vlerësimin negativ të një AME, ai mund ti drejtohet AAC me kërkesën për apelim.

Nëse e shih të arsyeshme AAC brenda 7 ditësh, do të ngrejë një grup për shqyrtimin e rastit. Për çdo vendim apo hapa të mëtejshme do të njoftohet zyrtarisht aplikanti.


Nëse çështja nuk do të zgjidhet me mjekun AME që ka kryer vlerësimin fillestar do të kërkohet rivlerësim nga një mjek tjetër AME i autorizuar.

Nëse Kontrollori i Trafikut Ajror shpallet i papërshtatshëm edhe rastin e dytë nuk do ti jepet mundësi tjetër apelimi dhe liçensa e tij do të pezullohet.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

ANEKSI 1 – APLIKIMI PËR LËSHIMIN, RIVLERËSIMIN DHE RINOVIMIN E LIÇENSAVE, KATEGORIVE DHE MIRATIMEVE

APLIKIMI PËR LËSHIMIN/RIVLERËSIMIN /RINOVIMIN E/(STUDENT) KONTROLLORIT TË TRAFIKUT AJROR [KTA] LIÇENSËS, KATEGORIVE DHE MIRATIMEVE						
Pjesa A: DETAJET E APLIKANTIT						
Emri:.....						
Adresa e përhershme:						
Tel: Cel:..... Adresa E-mai:						
Kombësia:						
Data (dd/mm/vvvv) dhe vendi i lindjes						
DETAJET E LIÇENSËS KTA /(STUDENT) (nëse është e aplikueshme):						
Nr. Serial i liçencës:						
Data e lëshimit (dd/mm/vvvv):						
DETAJET E PUNËDHËNËSIT (nëse është e aplikueshme):						
Emri:						
Pjesa B: APLIKIMI PËR (plotësoni kutitë përkatëse)						
<input type="checkbox"/> Lëshim i liçensës Student KTA, kategori(të) dhe miratimet) e kategorisë(Pjesa C, E dhe F e këtij formulari)						
<input type="checkbox"/> Miratim/etë gjuhës (Pjesa C, E dhe F e kësaj forme)						
<input type="checkbox"/> Lëshimi Liçensës KTA, kategori(ve) dhe miratimet e kategorisë(Pjesa C, E dhe F e këtij formulari)						
<input type="checkbox"/> Rivlerësim i kategorisë Liçensës KTA, miratimet(Pjesa C, E dhe F e kësaj forme)						
<input type="checkbox"/> Rinovimi kategorisë Liçensës KTA, miratimet (Pjesa C, E dhe F e kësaj forme)						
Pjesa C: KATEGORIA/MIRATIMI KATEGORISË/ NJËSIA ATC/ Sektori						
ADI <input type="checkbox"/>	(Njësia, sektori, pozicioni i punës)	TWR <input type="checkbox"/>	GMC <input type="checkbox"/>	GMS <input type="checkbox"/>	AIR <input type="checkbox"/>	RAD <input type="checkbox"/>
APS <input type="checkbox"/>	(Njësia, sektori, pozicioni i punës)	PAR <input type="checkbox"/>	SRA <input type="checkbox"/>	TCL <input type="checkbox"/>		
ACS <input type="checkbox"/>	(Njësia, sektori, pozicioni i punës)	TCL <input type="checkbox"/>	OCN <input type="checkbox"/>			
ACP <input type="checkbox"/>	(Njësia, sektori, pozicioni i punës)	OCN <input type="checkbox"/>				
ADV <input type="checkbox"/>	(Njësia, sektori, pozicioni i punës)					
APP <input type="checkbox"/>	(Njësia, sektori, pozicioni i punës)					
Miratimet e liçencës						
OJTI <input type="checkbox"/>	STDI <input type="checkbox"/>	Assessor <input type="checkbox"/>	miratimi i aftësisë gjuhës		miratimi i aftësisë gjuhës (specifiko gjuhën) lokale	
			— niveli 4 <input type="checkbox"/>		— niveli 4 <input type="checkbox"/>	
			— niveli 5 <input type="checkbox"/>			

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

			— niveli 6 <input type="checkbox"/>	— niveli 5 <input type="checkbox"/> — niveli 6 <input type="checkbox"/>
*Opsionale, nëse vendoset nga Shteti për arsye Safety dhe publikohet në AIP				

Pjesa D: Rivlerësimi /rinovimi i miratimit të njësisë

Aplikanti plotëson kërkesat sipas Urdhrit të Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, dhe skemës së kompetencës së njësisë.....
 Miratimet e njësisë/liçensës të shënuara më poshtë janë rivaliduar/rinovuar * (fshini sipas nevojës).
 Bazuar në këtë, **RIVLERËSIMI/RINOVIMI** mund të bëhet si më poshtë::

Miratimi njësi:		I vlefshëm deri:	
Miratimi njësi:		I vlefshëm deri:	
Miratimi njësi:		I vlefshëm deri:	
Miratimi njësi:		I vlefshëm deri:	
Miratimi njësi:		I vlefshëm deri:	
Miratimi njësi:		I vlefshëm deri:	

Unë vërtetoj që të dhënat janë të plota dhe të vërteta. Vlerësuesi i autorizuar:	Emri:	Numri i liçensës së vlerësuesit	Firma:
--	--------------	--	---------------

Pjesa E: Deklarimi

Unë nëpërmjet kësaj:


- aplikoj për lëshimin, Rivlerësimin/rinovimin e Liçensës KTA (student) ;
- konfirmoj që informacioni i përmbajtur këtu është i saktë në kohën e aplikimit;
- konfirmoj që unë nuk zotëroj asnjë Liçensë KTA (Student) të lëshuar në një Shtet tjetër;
- konfirmoj që nuk kam aplikuar për asnjë Liçensë KTA (Student) në një Shtet tjetër; dhe
- konfirmoj që unë kurrë nuk kam zotëruar një liçensë KTA (Student) lëshuar në një Shtet tjetër e cila ka qenë anuluar apo pezulluar.

Unë e kuptoj që çdo informacion I dhënë pasaktësisht këtu mund të më ndalojë mua nga zotërimi e një Liçense KTA (Student).

Firmosur: Emri:
 Data (dd/mm/vvvv):


Pjesa F: Certifikatat/Dokumentat

Ju lutem shtoni gjithë certifikatat dhe/ose dokumentat e përshtatshme:

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

1. Kopje e Liçensës Student KTA, nëse është e aplikueshme	<input type="checkbox"/>
2. Kopje e Liçensës KTA, nëse është e aplikueshme	<input type="checkbox"/>
3. Kopje e pasaportës ose ID tjetër kombëtare:	<input type="checkbox"/>
4. Kopje e certifikatës mjekësore:	<input type="checkbox"/>
5. Kopje e certifikatës/dokumentave trajnuese të përshtatshme që provojnë përfundimin me sukses të:	
(a) Trajnim fillestar (i integruar)	<input type="checkbox"/>
(b) Trajnim bazë.	<input type="checkbox"/>
(c) Trajnim i kategorisë.	<input type="checkbox"/>
(d) Trajnim e njësisë.	<input type="checkbox"/>
(e) Trajnim instruktori praktik	<input type="checkbox"/>
(f) Trajnim vlerësuesi.	<input type="checkbox"/>
(g) Trajnim rifreskues.	<input type="checkbox"/>
6. Kopje e certifikatës/ave të aftësisë së gjuhës(s): gjuha(gjuhët)	<input type="checkbox"/>
7. Deklarata/letra nga OSHNA e cila provon që zotëruesi i liçensës ka plotësuar kërkesat në përputhje me skemën e kompetencës së njësisë të miratuar, dhe kërkesate detajuara për çdo individ (shikoni pikat 5 dhe 8)	<input type="checkbox"/>
8. Kopje e formularit të vlerësimit të kompetencës	<input type="checkbox"/>
9. Kopje e*	<input type="checkbox"/>

** Kjo është lënë që çdo Autoritet të shtojë artikuj të cilët ata i konsiderojnë të përshtatshme brenda procesit të liçencimit .*

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

ANEKSI 2 – LIÇENSA KTA

Liçensa KTA e lëshuar në përputhje me Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, do të përmbajë specifikimet e mëposhtëme:


(a) Përmbajtja. Numri i pikës do të jetë gjithmonë i printuar bashkë me shkrimin orientues. Pikat nga I në XI janë pikat ”e përhershëm“, dhe pikat nga XI në XIV janë pikat ”e ndryshueshëme” të cilët mund të shfaqen në një pjesë të ndarë ose të ndashme të formularit kryesor siç përshkruhet më poshtë. Çdo pjesë e ndarë apo e ndashme do të jetë qartësisht e identifikueshme si pjesë e liçencës.

1. Pikat e përhershme:

- (i) Shteti i lëshimit të liçencës;
- (ii) titulli i liçencës;
- (iii) numri serial i liçencës me kodin e shtetit të Kombeve të Bashkuara (UN) të Shtetit të lëshimit të liçencës dhe të ndjekur nga `Liçensa KTA (Student)` dhe një kod me numra dhe/ose shkronja në numra Arabe dhe shkronja Latine;
- (iv) emri i plotë i zotëruesit (në shkronja Latine, edhe nëse shkrimi i gjuhës/ve kombëtare është i ndryshëm nga Latine);
- (iva) Data e lindjes;
- (v) adresa e zotëruesit, nëse kërkohet nga autoriteti kompetent;
- (vi) kombësia e zotëruesit;
- (vii) firma e zotëruesit;
- (viii) autoriteti kompetent;
- (ix) vlefshmërinë dhe autorizimet për privilegjet e dhëna, duke përfshirë datat kur u lëshuan për herë të parë;
- (x) firma e nënpunësit i cili lëshon liçensën dhe data e këtij lëshimi;
- (xi) firma ose vula e autoritetit kompetent;


2. Pikat e ndryshueshëme:

- (xii) kategoritë dhe miratimet me datat e përfundimit të afatit;
- (xiii) shënime: miratimet e aftësisë së gjuhës; dhe

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

(xiv) çdo detaj tjetër të kërkuar nga AAC.

- (b) Liçensa do të shoqërohet nga një certifikatë mjekësore e vlefshme, përveç rastit kur ushtrohen privilegjet STDI.
- (c) Materiali. Duhet të përdoren Letër e cilësisë parë dhe/ose materiale të tjera të përshtatshme, përfshirë letrat plastike, për të parandaluar që çdo ndryshim apo fshirje të kryhet lehtë. Çdo shënim apo fshirje në formë do të autorizohet qartësisht nga AAC.
- (d) Gjuha. Liçensat do të shkruhen në Anglisht {dhe, sipas kërkesës nga [emri i Shtetit], në gjuhën/ët kombëtare dhe gjuhë të tjera siç konsiderohet e përshtatshme} – vetëm nëse është e aplikueshme.


	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

MODELI I LIÇENCËS KTA

<p>Emri dhe logo e autoritetit kompetent (Anglisht dhe çdo gjuhë e përcaktuar nga autoriteti kompetent)</p> <p>Shteti (vetëm Anglisht)</p> <p>LIÇENSA E(STUDENT) KONTROLLORIT TË TRAFIKUT AJROR</p> <p>[Anglisht dhe çdo gjuhë e përcaktuar nga autoriteti kompetent]</p> <p>Lëshuar në përputhje me Urdhrin e Ministrit Nr. 91, Datë 21.02.2019, Rregulloren e Komisionit ,,,, (EU) Nr 2015/340 Kjo liçencë përputhet me standartet ICAO [Anglisht dhe çdo gjuhë e përcaktuar nga autoriteti kompetent]</p> <p>Formulari EASA 152 — Lëshimi 1</p>	<p>Kërkesa¹</p> <p>‘Bashkimi European’ të fshihet për Shtetet jo Anëtare -EU.</p> <p>Përmasa e çdo faqeje do të jetë një e teta A4.</p>
--	--


¹ Kërkesa:

Kjo faqe i referohet instruksioneve për plotësimin e Liçencës (Student) KTA dhe është e destinuar për përdorim nga ana e AAC. Lëshimet fillestare të kategorive, miratimeve të kategorisë, miratimeve të gjuhës, miratimit të

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

I	Shteti i lëshimit:	Kërkesat:
II	Titulli i liçencës:	
III	Numri serial i liçencës:	Numri serial i liçencës do të nisë gjithmonë me kodin e shtetit UN I cili lëshon Liçensën ndjekur nga numri I liçensës.
IV	Emri i plotë i zotëruesit:	
IVa	Data e lindjes:	Do të përdoret formati standart i plotë i datës, p.sh. dita/muaji/viti (psh., 31.01.2010)
XIV	Vendi i lindjes:	
V	Adresa e zotëruesit nëse kërkohet nga AAC: Rruga, qyteti, zona, kodi postar	
VI	Kombësia e zotëruesit:	E paraqitur nga kodi UN i Shtetit.
VII	Firma e zotëruesit:	
VIII	Autoriteti kompetent:	
X	Firma e nënpunësit i cili lëshon liçencën dhe data e lëshimit	
XI	Firma ose vula e autoritetit kompetent që lëshon liçensën	


vlerësuesit dhe instruktorit do të bëhen gjithmonë nga AAC. Rivlerësimi ose rinovimi i miratimeve të njësisë do të bëhet nga AAC.

	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

IX	<p>Vlefshmëria e privilegjeve: <i>Mbajtësit i jepet e drejta për të ushtruar privilegjet e kategorisë(ve) të mëposhtëme, kur validohen :</i></p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 50%;"><i>Kategoria(të)</i></th> <th style="width: 50%;"><i>Data e parë e lëshimit</i></th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> </tbody> </table> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 50%;"><i>Miratimi(et) e kategorisë</i></th> <th style="width: 50%;"><i>Data e lëshimit të parë</i></th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> </tbody> </table>	<i>Kategoria(të)</i>	<i>Data e parë e lëshimit</i>													<i>Miratimi(et) e kategorisë</i>	<i>Data e lëshimit të parë</i>																					<p>Kërkesat:</p> <p>Anglishtdhe çdo gjuhë e përcaktuar nga autoriteti kompetent.</p> <p>Data e lëshimit të parë të një kategorie dhe/ose miratimi i kategorisë do të jetë data e përfundimit me sukses të një trajnimit të përshtatshëm në atë kategori dhe/ose miratim kategorie.</p>
<i>Kategoria(të)</i>	<i>Data e parë e lëshimit</i>																																					
<i>Miratimi(et) e kategorisë</i>	<i>Data e lëshimit të parë</i>																																					

XIIa Kategoritë dhe miratimet me datat e përfundimit


Zotëruesit i jepet e drejta për të ushtruar privilegjet e kategorisë(ve) dhe miratimit(eve) të mëposhtëme të njësisë(të) në shërbimet e trafikut ajror për të cilat miratimi(et) e njësisë aktuale ë (janë) mbajtur të detajuara si më poshtë, vetëm nëse zotëruesi ka një certifikatë mjekësore të vlefshme:

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

XIII	Shënim: Miratimi(et) e aftësisë së gjuhës: [gjuha(gjuhët)/niveli/data e përfundimit]	Miratimi(et) e aftësisë së gjuhës, niveli, dhe data e përfundimit duhen përfshirë. Këtu të vendoset gjithë informacioni shtesë i liçencimit.
-------------	---	---

Shkurtime

Kategoritë e kontrollorëve të trafikut ajror		Kërkesat: N/A
ADV	Kontrolli Vizual i Aerodromit	
ADI	Kontrolli me Instrument i Aerodromit	
APP	Kontroll Proçedural i Afrimit	
APS	Kontroll i Afrimit me Survejim	
ACP	Kontrolli Proçedural i Hapësirës	
ACS	Kontrolli i Hapësirës me Survejim	
Miratimet e kategorisë		
AIR	Kontrolli Ajror	
GMC	Kontrolli i Lëvizjeve në Tokë	
TWR	Kontrolli i Kullës	
GMS	Survejim i Lëvizjeve në Tokë	
RAD	Radar	
PAR	Radar i Afrimit me Preçizion	
SRA	Survejim i Afrimit me Radar	
TCL	Kontrolli i Zonës Fundore	
OCN	Kontrolli Oqeanik	
Miratimet e liçencës		
OJTI	Instruktur Trajnimi në Vendin e Punës	
STDI	Instruktur Trajnimi i Pajisjes Sintetike	
ASS	Vlerësuesi	

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	Procedura për Lëshimin, Rivlerësim, Rinovimin, Pezullimin dhe Anulimin e Liçensave, Kategorive dhe Miratimeve, Autorizimeve të Përkohshme dhe Këmbimit të Liçensave	
	Zotëruesi	O2
	Dokumenti	O2-3-PRC.01

ANEKSI 3 – AUTORIZIMET E PËRKOHSHME

Modeli i autorizimit të përkohshëm:

I nderuar,

Në përgjigje të kërkesës për autorizim të përkohshëm [OJTI ose vlerësues] (ref. dokumenti xxx i datës dd/mm/vvvv), nëpërmjet kësaj unë ju njoftojmë se sipas situatës [listoni një nga situatat e mundësuar nga OSHNA në përputhje me listën e mundësuar në Kapitullin11] dhe në përputhje me analizën e safety të dërguar, OJTI/vlerësuesit e mëposhtëm:

[siguroni listën e emrave]

marrin autorizimin e përkohshëm OJTI/vlerësues për të ndërmarrë trajnim praktik dhe mbikëqyrjen e pozicionit operacional për kryerjen e vlerësimeve në [të shtohet tekst në përputhje me situatën e përmendur më poshtë për të cilat merret autorizim].

Vlefshmëria e autorizimeve OJTI/vlerësuese të përkohshme është [futni vlefshmërinë për secilin individ ose për grupin nëse data e përfundimit të miratimit OJTI është e njëjtë].

Emri

Pozicioni